



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 22.4. 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
22.04. 2011. GODINE

PRILL – APRIL  
2011

**E premte, më 22. 4. 2011,**

**Drejton seancën: nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhje janë të pranishëm 75 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Po startojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, të tjerat i dini. Atëherë, fillojmë, sipas radhës së të paraqiturve.

Për fjalë është paraqitur deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se përcaktimi i neve të zgjedhurit e popullit është mbrojtja e ligjshmërisë, pasurisë shtetërore dhe interesit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke qenë se jemi përcaktuar për shtet ligjor, veprim institucional dhe ... detyrës si tërësi, e krijimit të një shteti mbi baza ligjore etike dhe humane, duke qenë se e vërteta dhe e drejta është sinonim dhe kërkesë e shumicës së popullit tonë, si dhe e çdo shoqërie civilizuese dhe shtetit të ndërtuar mbi principe të ligjshmërisë dhe drejtësisë, unë kam mbledhur mbi 15 nënshkrime të deputetëve dhe kam iniciuar hetim ndaj deputetit Florin Krasniqi në organet përgjegjëse të hetuesisë dhe Prokurorisë së Kosovës, në Kosovë dhe në SHBA.

Një kopje të këtij iniciimi hetimor do t'ia ofroj Kuvendit, jo për ta shqyrtuar, se nuk është në kompetent të tij, po për të parë se çfarë njeriu të padenj ka vendosur në krye të një komisioni parlamentar.

Dhe, unë këtu e mbylli debatin me Florin Krasniqin, ngase nuk ia vlen të merrem me të, edhe ashtu ai ka refuzuar tri ballafaqime televizive dhe ia lë organeve kompetente të hetuesisë dhe të prokurorisë të merren me të dhe për akuzat, shpifjet që ai i bën në vazhdimësi, e ftoj të ndjekë rrugën e njëjtë.

Çështja e dytë dhe shumë me rëndësi është iniciativa e mbi 20 deputetëve të Parlamentit të Kosovës, të cilët kërkojnë që Kuvendi i Kosovës të distancohet nga të gjitha aktet e rënda kriminale të ndodhura në Kosovën e pasluftës. Kërkoj nga organet e hetuesisë të angazhohen për zbardhjen e këtyre rasteve dhe vënien e kryesve para drejtësisë. Parlamenti i vendit, si organi më i lartë legjislativ, duhet të ndërmarrë hapa në kompetencë të vet të marrjes së një qëndrimi më të vendosur dhe më institucional, të

qartë, të distancimit nga të gjitha aktet e rënda kriminale që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës, qoftë edhe përmes një rezolute të nxjerrë për këtë, pas debatit në Kryesi të Kuvendit dhe në Parlament. Dhe, në të njëjtën kohë, ky Parlament duhet të kërkojë në mënyrë insistuese që organet përgjegjëse të hetuesisë të shtetit tonë të ndërmarrin hapa të vendosur në drejtim të zbulimit të së vërtetës dhe vënies para përgjegjësive të autorëve të krimit.

Qe 12 vjet Kosova është liruar dhe mbi 10 vjet Parlamenti dhe politika jonë ka jetë institucionale në liri, me kompetenca të kufizuara, por edhe të plota në luftën kundër krimit, por fatkeqësisht rutina tragjike e përdorimeve, përkatësisht e keqpërdorimeve të rasteve të tilla, në realitetin tonë politik asnjëherë verbalisht nuk është ndalur, përderisa deri më sot rezultatet për ndriçimin e rasteve kanë munguar. Është momenti i skajshëm të ndalet kjo çoroditje, ku vetëm në raste kur ka qëllim për interes politik, për luftën për pushtet dhe eliminim politik, përdoren këto raste.

Shteti duhet t'u gjendet pranë familjeve të viktimave për të vendosur drejtësi në vend, për t'i mbrojtur jetën e tyre dhe pasurinë. Me këtë iniciativë, ne poshtë të nënshkruarit deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, kërkojmë që njërën nga seancat e ardhshme të futet në rend të dite të Parlamentit të Kosovës, që Kuvendi i Kosovës të distancohet nga të gjitha aktet ...

KRYESUESI: Tre minuta i ke, e kreve po më duket. Në emër të Grupit, atëherë edhe dy minuta. Paraqitu më herët...!

BEKIM HAXHIU: Me këtë iniciativë, ne poshtë të nënshkruarit deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, kërkojmë që në njërën nga seancat e ardhshme të futet në rend të dite të Parlamentit të Kosovës, që Kuvendi i Kosovës të distancohet nga të gjitha aktet e rënda që kanë ndodhur pas lufte në Kosovë, dhe kërkoj në plotësi të ndërmerren hapa të vendosur në zbulim të së vërtetës dhe vënies para përgjegjësive të autorëve. Iu mbetet grupeve parlamentare dhe Kryesisë së Kuvendit për të debatuar për nxjerrjen e një rezolute të tillë apo pëlqimit të përbashkët për distancim të Parlamentit nga aktet kriminale që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës. Këtë iniciativë do t'ia dorëzojmë administratës edhe kopjen tjetër.

Dhe, në fund, një çështje krejt tjetër, që ka të bëjë me iniciativën e përfolur nga deputeti Burim Ramadani, e ftoj që të mos tërhiqet nga kërkesa e tij dhe ne, edhe që kemi nënshkruar këtu, i premtoj Burimit që edhe do ta nënshkruajmë iniciativën për hetim apo për të diskutuar për Shërbimin Informativ të Kosovës, me kënaqësi, me nder dhe me përkushtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha – Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryesues,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,

Vizita në komunën e Rahovecit nga Komisioni për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, më 15 prill, pjesë e të cilit komision jam edhe unë, më kanë bërë përshtypje brengat dhe kërkesat e bujqve të kësaj ane, të cilat unë sot do t'i paraqes këtu.

Nga përfaqësuesit e komunës së Rahovecit kuptuam që komuna e Rahovecit në përgjithësi është një rajon tepër i përshtatshëm sa i përket zhvillimit të bujqësisë, por fatkeqësisht jo të mbështetur nga institucionet e Kosovës. Vreshtaria si një degë më e zhvilluar në këtë komunë dhe vreshtarët edhe pas intervenimit me subvencionin e vjetshëm nga Qeveria, kanë nevojë për mbështetje të mëtejme.

Përfaqësuesit e bodrumit të vjetër theksojnë se nga ky podrum, vitin e kaluar janë paralajmëruar ngjarje të padëshirueshme, por vërejtjet edhe kërkesat nuk janë marrë seriozisht. Kërkesat e tyre vazhdojnë të jenë: heqja e akcizës në verëra, sepse ajo definitivisht shkatërron punën dhe mundin e popullatës së kësaj ane. Arsyeja është se vera është përcaktuar si pije alkoolike e jo si produkt ushqimor, subvencionimi i derivateve të naftës për sipërfaqet me vreshta, hapja e kufijve, përkatësisht memorandum bashkëpunimi mes shteteve e vërejtje të tjera.

Gjatë vizitës në bodrumin "Stone Castle" u vërtetua në cilësinë e verës që prodhohet në Kosovë, i cili bodrum kishte jo më pak se 30 milionë litra verë, ndërsa të gatshme për shitje 16 milionë litra. Mendoj që duhet marrë parasysh seriozisht kërkesat e tyre, sepse vera është një nga artikujt të pakët që eksporton Kosova e me të cilët mund të mburret.

Kemi vizituar gjithashtu edhe Shoqatën "Krusha" në fshatin Krusha e Madhe, e cila shoqatë na befasoi për të mirë, ngase prodhimet e kësaj shoqate jo që i absorbon tregu, por kërkesat që ka tregu nuk mund t'i përgjigjen për shkak të kushteve jo të përshtatshme dhe mundësisë për t'i zgjeruar kapacitetet.

Prandaj, kërkoj nga ministri i Bujqësisë t'u dalë në ndihmë duke gjetur format dhe mundësitë për t'i ndihmuar këto gra të vyeshme, të cilat mbajnë familjet e tyre me punën që bëjnë, duke gjetur ndonjë formë të subvencionimit të biznesit të tyre, në mënyrë që të punësohen edhe gra të tjera që njëherësh janë mbajtëse të familjes, sepse shteti është edhe i tyre, e aq më tepër kur e dimë që të afërmit e tyre u flijuan për këtë shtet.

Këto ishin disa nga brengat e bujqve të kësaj ane. Komisioni do të vazhdojë me punën e tij në terren duke vizituar tani me radhë: komunën e Dragashit, Suharekës, Gjakovës e të tjera, ku mendoj që do të ballafaqohemi me probleme të natyrave të ndryshme, të cilat duhet t'i marrim seriozisht. Unë jam e vetëdijshme që jemi në epokën e teknologjisë informative, por si një vend me ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, brengat e bujqve duhet marrë seriozisht dhe duhet t'i tejkalojmë për t'ju dhënë mundësi për zhvillim të mëtejshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!  
Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në kohën kur të gjithë qytetarët e Kosovës prisnin që kjo Qeveri më në fund t’ia fillojë punës, ata u quan dhe shkuan në skijim, dhe atë në Bullgari. E aty na thanë se kanë punuar, se kanë arritur ta përpilojnë një që e quanin - vizionin ekonomik ose vizion për zhvillimin ekonomik të Kosovës, i cili i cakton edhe prioritete qeveritare për vitet 2011-2014. E çka të kuptojmë nga ky vizion i menduar dhe hartuar rishtazi, se Qeveria paska qenë pa vizion deri tash dhe se paska ardhur në pushtet pa e pasur as idenë më të vogël se çka do të bëjë me të. Se nëse kjo që e thashë nuk është e vërtetë, pra nëse Qeveria paska pasur vizion dhe program, atëherë çfarë kuptimi ka hartimi i këtij të riut, që e bën udhëtimin në Bullgari të jetë i rëndësishëm vetëm për rekreacionin e qeveritarëve dhe për asgjë tjetër. E nëse është kështu, atëherë a nuk na tregoni Qeveri e Kosovës, çka ju lodhi aq shumë që patët nevojë për këtë pushim skijimi?

Në fakt, kur lexohet prezantimi i paraqitur në publik me emrin pompoz “Vizioni i zhvillimit ekonomik”, shihet qartë se aty nuk ka asgjë të re. Të vetmen gjë për të cilën ka plan të qartë kjo Qeveri dhe të cilën e ka afatizuar ta përfundojë sivjet, është privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe shndërrimi i tyre në asfalt. Pra, kompanitë që na japin para në buxhet do t’i shndërrojmë në asfalt që na merr para prej buxhetit përmes kërkesës së vazhdueshme për mirëmbajtje.

Aty po ashtu thuhet se qeveria planifikon rritje ekonomike prej 7 deri në 8 % në vit, dhe ulje të papunësisë prej 8 deri në 10 % në vit. Mirëpo, ne jemi dëshmitarë të rritjes ekonomike prej 4 deri në 5% gjatë këtyre viteve të fundit, siç po thotë kjo Qeveri, dhe madje kemi edhe rritje të papunësisë. Në Kosovë konsiderohen të jenë diku rreth 380 mijë të papunë, varësisht prej ku e merr shifrën, kur t’ia shtojmë kësaj edhe afërsisht 25 mijë të rinj që hyjnë në tregun e punës për çdo vit, atëherë i bie që për ta ulur papunësinë për 10%, duhet të krijohen diku rreth 40 mijë apo 50 mijë vende të reja të punës në vit. E vizioni i Qeverisë nuk na tregon aspak se në cilët sektorë do të ndodhë kjo dhe vetëm na thonë se do ta bëjë.

Me rritjen e fundit të pagave në sektorin publik ne e kemi parë që kjo Qeveri nuk i ka edhe aq punët mirë me përqindje. Pra, një përqindje e premtos, ndërkohë që tjetrën shumë më të vogël e realizon.

Në vizionin e qeverisë pastaj flitet edhe për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, në të cilën thuhet se prioritet do t’i jepet linjës hekurudhore që e lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë, ndërkohë që Kosova nuk ka kurrfarë lidhje hekurudhore me Shqipërinë, lidhje kjo që do të ishte e pazëvendësueshme për transportin e mallrave, rritjen e këmbimit tregtar mes nesh, lidhjen strategjike mes nesh dhe veçanërisht që është shumë e rëndësishme, do të lehtësonte shfrytëzimin e Portit të Shën Gjinit për nevojat e Kosovës. Vizioni i qeverisë nuk duket të jetë i interesuar për këtë lidhje, por ata janë të interesuar të na lidhin me hekurudhë me Serbinë dhe Maqedoninë.

Pra, për fund kisha dashur t’ia shtroj një pyetje Kabinetit qeveritar dhe kjo është - A e keni ndërmend të zbrisni nga skitë ndonjëherë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Mendoj që për pyetjen Qeveria mund të japë përgjigje, jo në pjesën e caktuar për pyetje, jo tani.

Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sot kemi pasur në plan që në këtë pjesë të rendit të ditës t'i ngremë nga dy ose tri çështje, një pjesë të asaj të tretës të cilën e kam përgatitur, e mori Visari, po prapëseprapë mirë e tha.

Fillimisht mbrëmë ka ndodhur një ngjarje e keqe në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, mund t'ju them se ka kohë që unë nuk jam ndier aq keq, d.m.th. një rrahje e tillë të tifozëve të cilët nuk kanë provokuar, nuk e kemi parë në Kosovë që një kohë tepër të gjatë.

Më vjen keq që kryeministri nuk është këtu, por është ministri i Punëve të Brendshme, është punë juaja, zoti ministër, aso mësymje në të rinjtë e Kosovës nuk kam parë, të paktën që nga 13 vjet. Më vjen keq që duhet ta them kështu, po ju që i keni marrë ato vendime, i keni bërë tri ose katër punë shumë të këqija, na keni lënë me shije të keqe, e keni ngacmuar keq Policinë e Kosovës, e keni shtirë një pykë të keqe vetë Policinë e Kosovës e cila është multietnike dhe duhet të jetë multietnike. Edhe në të njëjtën kohë ju që po doni të ndërtoni marrëdhënie të mira ndërnacionale, po ju them që me vendimet që i keni marrë keni bërë goxha shumë dem për t' i shkatërruar ato edhe pak më tutje. Mund të them që dje mu ka dukur thua se jemi rrahur edhe ne në Kuvend të Kosovës, me ato skena që i kam parë në televizion, këtë e ndava vetë.

Çështje tjetër është për ministrin e Financave, nuk ka pasur nevojë të shkojë në Bullgari që të na sjell Raportin e shpenzimeve për vitin 2010. Më 31 mars ka qenë dashur të jetë këtu, e keni thyer çdo ligj të mundshëm, të sillni raportin se është për provizion ligjor duhet ta kenë raportin deputetët, nuk bënë kështu, kur doni ju ta sillni, kur doni mos ta sillni.

Edhe e treta është Bullgaria. Seriozisht po ju them më ka ardhur turp, jam ndier keq, jam djersitur, jo për shkak se jam opozitë, po si njeri i Kosovës. Pse, bre në Bullgari? Nuk po flas për Bullgarinë se është ndonjë vend i keq, sepse Bullgaria është vend mik dhe na ka njohur si shtet, por pse jashtë Kosovës, hajde? Këta njerëz, këta patriotë që duhet t' i nxisin investimet në Kosovë, këta njerëz që duhet ta nxisin turizmin në Kosovë, këta shkojnë si mushkonjat, shkojnë jashtë Kosovës, domethënë i thonë- ju populli i Kosovës ju rrini këtu, po ne s'mund të rrimë këtu se ne nuk mund të punojmë këtu në Kosovë, ne duhet të shkojmë në Bullgari për të punuar. Jam kujtuar shumë prej kah ka dalë kjo ide, kjo ide adoleshente është adoleshente tash dua t'ju shpjegoj pse është adoleshente. Kjo ide me siguri ka dalë diku ndoshta prej Ministrisë së Tregtisë, se i kanë do ide gjenialët ata atje që janë ata gjenialë aty, i kanë do ide kësajose të na turpërojnë.. Jam kujtuar vetë me veti çka kishim menduar ne po të vinin nga 7 ministra të Bullgarisë diku në Kaçanik edhe ta bënin një plan zhvillimor për Bullgarinë, çka kishim menduar ne për ata. Tash paramendoni çka mendojnë ata për ne, faqja e zezë, faqja e zezë. Domethënë, kësaj pune i thonë hëm arnaut hëm turist që thoshte dikush. Mu kanë dukur këta adoleshentët sikur në shkollë të mesme nxënësit që thonë- hajde t' i bëjmë detyrat e

shtëpisë në park edhe pas një 10 minutave ia nisin të luajnë biz- biz a xiu qysh është ajo loja nuk e di çka kanë bërë këta njerëz të na qesin kështu faqen e zezë, thua se Kosova nuk ka vend ku këta mund të shkojnë. Hajde se po supozoj që ka qenë dashur të dalin diku, të jenë më të qetë se janë lodhur, që tha Visari, janë këputur, janë dërmuar po kanë mund të shkojnë në Rugovë, bre, kanë mund të shkojnë në Brezovicë sa për atë punë, kanë mund të shkojnë ose në Prevallë ose në Shalë të Bajgores se kemi shumë vende, po ndoshta nuk janë mësuar të rrinë në hotele të kategorisë tretë po duan të parës edhe pse ndoshta ku ta dimë ku kanë fjetur para pak kohe. Ka të bëjë me patriotizëm, unë bëra pak humor po mbani në mend ka të bëjë me patriotizëm. Nëse këta që unë po i quaj patriotë profesionist që marrin rrogë nuk e tregojnë as minimumin e patriotizmit kur e bëjnë punën e vet, qysh kanë të tregojnë patriotizëm njerëz të tjerë, është antipatriotike edhe që të mos keqkuptojmë disa njerëz që janë standard keqkuptues të qëllimshëm. Nuk po flas për nacionalizëm, po flas për patriotizëm, edhe nëse këta nuk janë patriotë, nëse këta nuk e tregojnë këtë minimum të patriotizmit çka të presim prej njerëzve tjerë? Ka të bëjë me patriotizëm edhe ministrat duhen të jenë patriotë, bile pak. Nuk po lypj ku ta di çka të bëjnë, se e keni parë që s'mund të bëjnë më shumë, po bile pak bre, pak pa patriotë, t'ju vijë inat të shkojnë të bëjnë plan zhvillimor jashtë vendit, edhe çfarë plani bëjnë këta? Këta kurrfarë plani s'bëjnë se këta s'dinë të bëjnë plan, planin e bëjnë ekspertët, këta duhet të ulën një gjysmë pasdite edhe të thonë qysh duam ta zhvillojmë Kosovën? A duam ta bëjmë vend bujqësor, a industrial apo krikombinim, ky është vizion për ta qitur, një vizion për një pasdite edhe domethënë prapë është e vërtetë Visar nuk e kanë pasur, se po ta kishin për dy orë e kishin harmonizuar mes veti.

Ju ndava këto tri tema që më kanë bërë pak a shumë të turpërohem, sidomos e para dhe e treta. E para më ka bërë të turpërohem të na rrahin ashtu midis .....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini!  
Fjalën e ka deputetja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK:  
Sayın Kosova Meclisi Başkan yardımcısı  
Sayın Başbakan yardımcısı  
Sayın Bakanlar  
Değerli Milletvekilleri

Teşekkür ederim.

Üç yıllık ülkemiz Kosova birçok önemli konu ve sorunlarla karşı karşıya gelmektedir. Çok önemli olan konular arasında halkımızın karşılaştığı önemli bir konu elektrik enerjisidir.

Yıllardan beri çözülemeyen elektrik sorununa bugüne kadar ciddi bir şekilde yanaşmadığını ve önerilen çözümler arasında her zaman ailelerin elektrik tedarikinden kesilmesiydi.

Harcadığı elektriğin ödemesini yapamayan vatandaşların bulunduğu mahalelerde elektrik kesintisi 3 gün süreyle kesilmektedir bu vatandaşların temel ihtiyaçlarını karşılaması için bir sorun.

Është enë më e mirë se të tjerat, por edhe kështu, nëse nuk ka një plan të qartë, atëherë do të jetë një dështim. Është e rëndësishme të kuptohet se kjo nuk është një dështim i vetëm, por një dështim i tërësishëm. Është e rëndësishme të kuptohet se kjo nuk është një dështim i vetëm, por një dështim i tërësishëm. Është e rëndësishme të kuptohet se kjo nuk është një dështim i vetëm, por një dështim i tërësishëm.

Fërsattan yararlanarak Kosova Meclisi Milletvekili olarak 23 Nisan- Kosovalı Türklerin Milli Bayramını en içten dileklerle kutlar çalışmalarında başarılar dilerim.

İlginize teşekkürler

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAËU: I nderuar kryesues,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë për Inteligjencë të Kosovës ka realizuar një vizitë në Republikën e Shqipërisë, nga data 14 deri në datën 15 prill 2011. Në përberje të delegacionit kanë qenë Florin Krasniqi, kryetar i Komisionit, Fadil Demaku, nënkryetar, Ymri Ahmeti, anëtar dhe Duda Balje, anëtare që ka marrë pjesë vetëm në takimin e parë.

Duke qenë i vetëdijshëm se çdo vizitë zyrtare jashtë vendit na ngarkon me përgjegjësinë se atje nuk jemi përfaqësues të propagandave partiake, as fushatave politike që tek ne dinë të jenë denigruese dhe jashtë kontrollit, ne jemi të obliguar si përfaqësues të institucioneve të vendit të kemi sjellje dhe prezantim dinitoz, gjithherë në funksion të qëllimit të vizitës dhe në përputhje me ligjin.

Me zotën Florin Krasniqi ka ndodhur e kundërta gjatë vizitës që kemi pasur në Republikën e Shqipërisë. Edhe atje ai ka vazhduar me fjalorin e tij të njohur prej kur ka ardhur në Kosovë e që mund të përmbledhet me fjalët: kriminelët, hajnat, milionat, bandat e tjerë. Kjo është platforma e tij e që për mendimin tim përfaqëson vetë retrospektivën e rrugëtimit të personalitetit të Florin Krasniqit.

Me këtë gjuhë dhe këto shprehje thyese ai në vazhdimësi fatkeqësisht ka manipuluar një pjesë të opinionit, një pjesë tjetër vazhdon të bëjë një lloj presioni psikologjikë, ndërsa pjesës më të gjerë të opinionit citoj: “ua fyen edhe inteligjencën”

Gjatë vizitës nuk ka përfillur asnjë procedurë protokulare, ka shfaqur nivelin më të ulët të mundshëm të prezantimit, ka ngritur çështje që s’kanë të bëjnë fare me kompetencat e Komisionit, ka trajtuar tema aspak të përshtatshme, duke treguar historitë e tij private, duke humbur krejtësisht kuptimin dhe qëllimin e takimeve që kishim në institucionet e shtetit shqiptar. Duke shpifur i ekzaltuar dhe krejt jashtë kontrollit ai në ato takime ka shpalosur misionin e tij personal siç e quante ai ” gjëja për çlirimin e vendit nga Hashim Thaçi, PDK-ja dhe bandat e tij” Kjo ishte tema kryesore e Florin Krasniqit në të gjitha takimet duke atakuar plotë emra të përveçëm që bartin pozita të rëndësishme institucionale në vend. Misioni i Florin Krasniqit ma kujtonte misionin e Don Kishotit. Ka keq përdorur pozitën në mënyrë të papërgjegjshme e ndoshta edhe të pavadishme në

mungesë të njohurive më elementare duke mos e kuptuar se nuk përfaqëson vetën e tij, por institucionet e vendit.

Këtë çështje po e ngriti para deputetëve të nderuar për t'i tërhequr vëmendjen deputetit Florin Krasniqi që në të ardhmen ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Shkurt bjeri, mbylle, edhe 10 sekonda jepja ta mbyllë!

FADIL DEMAKU: ...jashtë vendit apo në Kosovë që kur të ketë takime me komisione homologe apo të përafërta të jetë më i përgjegjshëm dhe në tjetër nivel të prezantimit të përfaqësimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pra, le ta përmbyllë pastaj duhet t'ja japim fjalën Florinit pa rend. Florinit, pa rend, mandej.

FADIL DEMAKU: ... sepse me .. e tanishëm, ai krijon imazhin e padëshiruar të Komisionit të vetë Parlamentit tonë, të institucioneve të vendit tonë përpara institucioneve ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!  
Fjalën e ka Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Transparenca dhe llogaridhënia janë attribute fundamentale të demokracisë, edhe pse ky Kuvend ka aprovuar një varg ligjesh për të forcuar këto dy komponente jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë, për fat të keq deri tani ka munguar vullneti ndoshta edhe me qëllime të caktuara në zbatimin e këtyre dy ligjeve.

Shumë organizata vendore ndërkombëtare dhe opinioni i gjerë kosovar dhe më gjerë ka ngritur shqetësimet e tyre për mungesën e transparencës dhe llogari dhënies në institucionet tona publike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të isha shumë i nderuar të ishte këtu kryeministri, por besoj që ka mjaftueshëm zëvendëskryeministra për të dëgjuar atë që unë kam ndërmend për të thënë.

Më lejoni të sjelli vëmendjen tek mospublikimi i kontratës për ndërtimin e autostradës Mendarë – Morinë. Shkas kam fjalën e kryeministrit ditën kur ka nisur asfaltimi i kësaj autostrade. Jemi mësuar të dëgjojmë shumë nga kryeministri se si flet për transparencën e Qeverisë, por e vërteta është krejt e kundërt. Përkundër interesimeve të publikut,

përkundër obligimit ligjor Qeveria edhe më tutje po vazhdon ta mbajë të mbyllur këtë kontratë dhe të painformuar publikun lidhur me këtë. Tani veç kur na nisur asfaltimi i kësaj autostrade kryeministri nga atje deformon çdo interesim të opinionit, deformon çdo interesim të qytetarëve për transparencën e këtij projekti, dhe imagjinojnë kundërshtarët, imagjinojnë kritikët e ndërtimit të autostradës dhe nga atje na flet për super transparencën.

Zoti kryeministri nuk di për çfarë transparence na flet derisa askush sot në Kosovë me ndonjë përjashtim të rrallë, as ky Parlament nuk i di kushtet e nënshkrimit të kësaj kontrate, askush sot as ky Parlament nuk e di koston financiare të kësaj autostrade, aq më keq nuk e dimë si po realizohet ky projekt, me që nuk ka fare organ mbikëqyrës edhe pse normativa ligjore obligon punëdhënësin, përkatësisht Ministrinë e Transportit, e cila hiq më larg se në janar të këtij viti ka marrë edhe një dënim të konsiderueshëm me gjobë nga organi i shqyrtimit të prokurimit publik për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Nuk e dimë as trasenë e rrugës dhe në opinion ka dyshime sa kah do të shkojë kjo autostradë për të cilën mendoj që ky Kuvend duhet të marrë përgjegjësinë. Nuk dimë asgjë as për vlerësimin e pronave rreth shpronësimit, komentohet se ka shumë pazare në këtë drejtim.

I nderuar Kabinet qeveritar,  
Kritikët nuk janë kundër ndërtimit të autostradës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe 10 sekonda ia shtoni!

IMRI AHMETI: Atëherë po e mbylli! Më në fund, mendoj që ky Kuvend duhet të fillojë ta ndryshojë këtë gjendje, kjo është përgjegjësia jona kushtetuese, është përgjegjësi ligjore...

KRYESUESI: Faleminderit!  
Fjalën e ka deputetja Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

ALMA LAMA: Unë e kam kundër ministrave, po këta po ikin.  
Zoti kryesues,  
Të nderuar deputetë,

Ditëve të fundit Qeveria e Kosovës ka ndezur makinën e propagandës dhe po tenton t’iu hedhë hi syve qytetarëve të këtij vendi, nga dy drejtime.

Së pari, nëpërmjet një farse të përgatitjes së planit të zhvillimit ekonomik, gjoja të përgatitur në Bullgari. Merreni me mend, u shkëputen nga puna e tyre e përditshme për një javë, për të prodhuar një dokument, i cili thoshte se Posta duhet shitur, se duhet ndërtuar termocentrali “Kosova e Re” dhe se do të ketë rritje të zhvillimit ekonomik deri në 10%. E pra, qendra rekreative në Bullgari duket se u shërbeu që të bënin zbulime të

mëdha. Me shitjen e Postës duket se zbuluan ujin e nxehtë, me ndërtimin e termocentralit duket se shpiken për herë të dytë rrotën e qerres, e për sa i përket rritjes ekonomike, zbuluan se ajo mund të bëhet me urdhër të peshkut.

Kanë mundur t'i bëjnë këto shpikje të mëdha edhe në Kosovë, po si duket u ka munguar inspirimi të cilin, për fatin tonë të madh, ua dha qendra e skijimit në Bullgari.

Qytetarët e këtij vendi duhet ta dinë se bëhet fjalë për një farsë, e cila jo që nuk është plan ekonomik, por është një dokument i prodhuar nga paniku i kolapsit ekonomik, në të cilin kjo qeveri po e zhyt vendin. Ky dokument ka vetëm një synim, nëpërmjet shitjes së objekteve strategjike të mbushë vrimat buxhetore, të krijuara si pasojë e një politike të keqe dhe dritëshkurtër. Nga ana tjetër, ata që i kane dy pare mend në kokë, e dinë mirë se nuk ka zhvillim ekonomik pa rritje të vendeve të punës, e kjo bëhet nëpërmjet rritjes së prodhimit vendor, e ky i fundit bëhet nëpërmjet investimeve e mbështetjes së bizneseve, e jo rrënimit të tyre, siç po bën Qeveria, e cila me këto politika ekonomike e ka shndërruar Kosovën në një han pa porta, ku gjithkush mund të sjellë prodhimet e veta.

Së dyti, makina e propagandës po prodhon edhe një retorikë të fortë kundër misionit të EULEX-it, madje puna ka arritur deri aty sa disa zyrtarë të kësaj qeverie po e quajnë trimëri të madhe këtë, pra që po flasin kundër EULEX-it.

Po akuzohet ky mision se ka dështuar, se po e pyet si shumë Beogradin për të ndërmarrë veprime në veri, se nuk po i kthen gjykatësit në punë atje.

Askush nuk mund të pretendojë se këto nuk janë të vërteta, por unë ju pyes zotërinj, a nuk ju duket pak si vonë për të kritikuar?

Këto probleme me këtë mision janë të hershme dhe janë prezent që përpara zbarkimit të tij në Kosovë, sepse problemet ligjore rreth zbarkimit të tij “u zgjidhën”, vetëm pas arritjes së një marrëveshjeje me kryeqytetin serb dhe dihej se çfarë pasojash do të prodhonte kjo situatë.

Pasojat janë evidente më së shumti në pjesën veriore. EULEX ka dështuar tërësisht të përmbushë mision e tij, sepse për çdo veprim kërkon leje nga Beogradi dhe ky i fundit luan me të si macja me miun.

Ne që shohim përtej interesave të ngushta personale, e që nuk kemi frikë t'i kritikojmë ndërkombëtarët kur gabojnë, e kemi vënë me kohë alarmin për këtë çështje.

Por hilja e kësaj retorike anti-EULEX qëndron diku tjetër. Përveç interesit për të zhvendosur vëmendjen nga problemet e mëdha ekonomike me të cilat po ballafaqohen qytetarët për çdo ditë, duket se dikush po kërkon t'i fusë frikën misionit të BE-së për sundim të ligjit, i cili herë pas here flet për afera korruptive e për dosje korupsioni. Hipokrizia qëndron në faktin se në vend që të përkrahet në këtë angazhim, sulmohet, e në vend që të sulmohej për dështimin e tij në veri, gjithë këto vite është heshtur.

Në rast se këto kritika do t'i kishin seriozisht, përse kjo Qeveri apo Parlament nuk bën presion aty ku duhet për të shqyrtuar me të vërtetë raportin me institucionet që e kanë sjellë misionin e BE-së në Kosovë, misionin EULEX, i cili është thirrur të vijë për të punuar në sundim të ligjit e jo për të bërë politikë e për të zhvilluar negociata me Beogradin.

Është mirë pra që këta zyrtarë të Qeverisë të na tregojnë se si ka mundësi nga ana tjetër që policët serbë në mes të Prishtinës të rrahin qytetarë shqiptarë. Ky është një provokim i hapur i cili, përveç të tjerash, është edhe mungesë profesionalizmi.

Në përfundim, i bëj thirrje kësaj qeverie që në vend të makinës së propagandës që tenton të na shesë dushk për gogla, të fillojë të punojë me të vërtetë për interesat e vendit, se me këtë qasje Kosova do të hyjë, nëse s'ka hyrë deri tani, në listën e shteteve të dështuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Kohëve të fundit edhe viteve të fundit kemi dëgjuar lloj deklaratash, prej atyre për angazhime patriotike, kombëtare, shtet-formuese, deri te ato për kriminalitet, hajni, përfitime marramendëse e çka jo tjetër, dhe gati si çdo herë gjatë këtyre viteve është e pamundur që të mos përmendet një organizatë që njihet me emrin SHIK- Shërbimi Informativ i Kosovës.

Jam i bindur se këto zhvillime disavjeçare tashmë prej kodrës në kodër, ashtu po e quaj këtë debat, kanë hutuar opinionin publik në Kosovë dhe për më keq nganjëherë edhe i kanë tmerruar me episode të ngjashme me filma aksion – horror.

Mbi të gjitha, këto tregime kanë vazhduar të jenë pakonfirmuara dhe brenga ime personale është se për shkak se nuk janë të konfirmuara, këto do të vazhdojnë me episode të reja për shumë vite të ardhshme. Prandaj, besoj se debatit prej kodër në kodër duhet t'i vijë fundi dhe jemi dëshmitarë se tashmë në Kuvendin e Kosovës ka njerëz që thonë publikisht se kanë qenë anëtarë të kësaj organizate, derisa ka njerëz të tjerë që akuzojnë për të bëmat e asaj organizate, sipas tyre, por besoj fatmirësisht, ka edhe të tillë që nuk duan asgjë më shumë se sa vetëm të marrin vesh se për çka po bëhet fjalë. Thënë thjeshtë, është pyetje edhe kërkesë krejt legjitime e një deputeti ose shumë deputetëve të pyesin si për çka po bëhet fjalë dhe kush është ky farë SHIK-u.

Ky institucion duhet të themelojë një komision hetues parlamentar në pajtim me Kushtetutën e Republikës dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, i cili do të merrej me këtë temë dhe për bindjen time janë 4 fusha ose elemente për të cilat do të duhej që të interesohej ky komision i mundshëm.

E para, cila është baza ligjore me të cilën ka funksionuar SHIK-u?

E dyta, cili ka qenë financimi i kësaj organizate dhe si janë menaxhuar fondet?

Së treti, cili ka qenë mandati, mekanizmat, kontrollues të brendshëm dhe mekanizmat mbikëqyrës institucional të jashtëm, dhe

Së katërti, duhet të shihen dhe të vlerësohet procedurat, metodat edhe destinimi i mbledhjes së informatave, klasifikimi i tyre, ruajtja dhe raportimi i tyre.

Këto janë fusha të përgjithshme që një institucion, si Kuvendi i Kosovës, ka të drejtë që të merret dhe ju ftoj që të mos i shihni bardhë e zi gjërat dhe kam besim të plotë se do të ketë mbështetje të deputetëve të gjitha grupeve parlamentare dhe këtë nismë krejt personale do t'ia paraqes sot Grupit Parlamentar të PDK-së, atij të LDK-së, të “Vetëvendosjes”, Grupit Parlamentar të Aleancës dhe Koalicionit për Kosovën e Re. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

I fundit, që është më shumë se koha ka kaluar për deklarata dhe për paraqitje, është Halit Krasniqi, që e ka një shqetësim për regjionin nga vjen dhe do t'ia jap fjalën jashtë orarit. Të tjerët mund të paraqiten në seancën e ardhshme. Emrat, regjia le t'i evidentojë sipas Rregullores, në qoftë se ka ndonjë kërkesë shtesë, si grupe parlamentare.

**HALIT KRASNIQI: Përshëndetje, për të gjithë!**

Unë do të ngrejë një shqetësim që është aktual më se 10 vjet dhe jemi para muajit kur fillon ky shqetësim për zonën e Prizrenit, me epiqendrën në Malishevë, që kryesisht është me pasoja vdekjeprurëse dhe për çdo vjet bëhen angazhime qeveritare, ekipe të ndryshme profesionale, po vdekjet nuk ndalen dhe gjithmonë ato sjellin shqetësime edhe kur nuk përfundojnë me vdekje rastet të cilat preken nga epidemia e etheve hemoragjike. Sikur të ishim nga: Ratkovci, Senovci, Pataqani, Dobërdolani, Prizreni, Zhuri, Guri i Kuq, Llapqeva, Carallukë, Lladrovci, Kraj, Bratotin, Lëmizhda, Bubël, Dragobil, Zymi, Panoc, Karashingjergj, Leqan, Senovci dhe Zajmovë, sigurisht që këtë problem do ta ngitnim më shumë shqetësim. Për çdo vit vetëm në Malishevë ka nga 1400 deri 1600 pickime, të cilat kanë përfunduar kryesisht bashkërisht në të gjitha këto fshatra më 28 vdekje. Tani unë e lus këtë Qeveri që t'i mobilizojë seriozisht, para se të fillojë maji, të gjitha ekipet profesionale dhe të ndaj mjete të domosdoshme që kjo epidemi të ndalet dhe këto shqetësime të mos përsëriten më te banorët, sepse edhe në rastet kur rastet e pickimeve nuk përfundojnë me vdekje, sjellin aq ankth dhe shqetësime te familjarët, sa që nuk mund të përshkruhen në këtë foltore. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së ka kërkuar fjalën, s'po e di për çka.

**ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!**

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi dëshmitarë vërtet që në Kosovën e pasluftës kanë ndodhur krime nga më të rëndat, duke filluar nga vrasjet e njerëzve, të cilësuar si vrasje politike dhe emra dhe epitete të ndryshme. Shumë familje presin në ankth që këto vrasje të zbardhen. Kanë ndodhur krime të rënda edhe ekonomike, keqpërdorime, korrupsion dhe çka s'ka ndodhur tjetër.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mbështesim fuqishëm iniciativën e deputetit, gjegjësisht të Grupit Parlamentar të Aleancës që të krijohet ky komision, por me kusht që vërtet ky komision të ketë një fushëveprim, të ketë mbështetje të fuqishme që këto raste të zbardhen njëherë e përgjithmonë dhe të gjithë aktorët e këtyre krimeve të rënda që i kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha të gjithanshme vendit tonë të përfundojnë dhe të gjithë të dalin para gjyqit dhe të japin llogari. Është momenti i fundit kur duhet të kalojmë nga fjala vërtet në vepër. E kemi gojën plot me shprehjen - askush mbi ligjin, është momenti i fundit kur vërtet të gjithë duhet të jem përgjegjës dhe të japim llogari para ligjit, duke përfshirë të gjitha nivelet. Kërkoj që të fillohet nga deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe të shtrihet në të gjitha nivelet e tjera dhe ata të cilët janë të implikuar në çfarëdo krimi qoftë ai, duhet të dalin dhe të japin llogari para ligjit. Kërkoj nga qeveria që këtij komisioni t'i japë mbështetje të gjithanshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Nejse, Adem, e keqpërdorove, se unë mendova që e ke për procedurë. Okej. Kjo pikë e rendit të ditës ka përfunduar. Janë 5 deputetë të paraqitur, tash kur fillon pika - pyetje- përgjigje... Ju, deklaram, po. Mund të deklaroheni në emër të Qeverisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë do të provoj t'ju jap disa sqarime, nëse më lejohej ta them si për pjesën që u atakua apo u tangua Qeveria. Unë po e them në fillim, paksa shaka, nuk e kemi ndërmend të japim përgjegjësinë për skijime, po as s'e kemi ndërmend të luajmë pingpong dhe ky mendimi ynë, do të thotë, më shumë do të punojmë me orientimet tona me perspektiva se sa që të merremi me deklaratat këtu.

Ky slogani: "ka hip në skia" është mirë për ndonjë tubim me studentë, për Kuvend është më pak, Visar. Por atë çka mund të themi, është që këtu po flitet për më shumë për formën se sa për përmbajtjen. Ne jemi të gatshëm që ta bëjmë planin e aksionit, pra planin e veprimit të prioritetëve ekonomike ta biem në Kuvend dhe ta diskutojmë bashkë me ju, t'i pranojmë ndryshimet që mund t'i keni. Natyrisht, jo ndryshimet konceptuale, po ndryshimet që janë të pranueshme për ne, për shumicën në Kuvend, po besoj edhe shumicën e qytetarëve dhe në këtë debat do të marrin pjesë edhe shoqëria civile, e besoj edhe të tjerët, në veçanti edhe bota e biznesit.

U përmend rasti nga zoti Gjini që ka të bëjë me sjelljen e Policisë, nuk qenka zoti Gjini këtu. Unë po e them që edhe ministri i Brendshëm ka thënë mbrëmë, do të ketë hetim edhe për sjelljen e policisë dhe unë po e them, po ashtu, në rast të veprimeve jo ligjore se është slogan i jonë i njohur- ligji sundohet me ligj dhe askush nuk ka të drejtë në emër të ligjit të keqpërdorë ligjin. Kjo vlen edhe për policinë edhe për drejtësinë dhe për të tjerët.

Zoti Ahmeti e përmendi transparencën. Po e nguci paksa në shaka, kur ke qenë në Qeveri, nuk e ke kërkuar këtë, se ta kishim dhënë, zoti Ahmeti, po nëse keni dëshirë këtë do ta bëjmë.

Alma, pasi e përmendi makinën e propagandës, Alma vetë fjala makinë e propagandës është propagandë dhe autorin besoj ju e dini, po unë s'kisha dashur ta përmend. Por, ajo çka mund të themi, nuk është Qeveria anti-EULEX, Qeveria ka kërkuar dhe kërkon prej EULEX-i rend dhe ligj dhe ne e kritikojmë kur ata nuk e zbatojnë rendin dhe ligjin, qoftë në Prishtinë, qoftë në Pejë, qoftë në Gjakovë, qoftë kudo dhe reagimi ynë ka qenë plotësisht i drejtë dhe sot e them prapë, ne kemi kërkuar që të ketë gjykata në veriun e Kosovës, kemi kërkuar vazhdimisht, kemi kërkuar që të ketë një sistem unik të sistemi i drejtësisë, kemi kërkuar që të ketë një hierarki të emërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe kemi kërkuar të ketë ligje të aplikueshme në tërë territorin e Republikës. Dhe, unë po them si ministër i Drejtësisë, asnjë veprim tjetër së paku unë s'e pranoj ta bëj asnjëherë, mund të mos jem ministër i Drejtësisë, po jo të bëj veprime të tjera, ndërsa veprime tjera e ftoj EULEX-in që t'i kryejë të gjitha kompetencat që i ka në raport me rendin dhe ligjin, duke filluar nga unë.

Ndërsa, sa u përket çështjeve që po përmenden këtu, unë kisha dashur që të jepet mundësi secilës temë veç e veç. Qeveria e Kosovës do të japë kontributin e vet për debat konstruktiv, për debat që i kontribuon edhe punës së Qeverisë, edhe Kuvendit, por edhe në dobi të qytetarëve të Republikës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në pajtim me nenin 45. pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti 2 pyetje, për t'ia përkujtuar disave që i kanë bërë 10 pyetje për sot, domethënë për seancën e ardhshme, dhe ne i kemi kufizuar në dy. Faleminderit!

Sipas radhës, deputetja Time Kadrijaj, ka një pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

Deputetes Kadrijaj, fjalën, ju lutem!

TIME KADRIJAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Për shkak të kontrollit të dobët ose të mos kontrollit të pikave doganore 1 dhe 31, buxheti i Kosovës humb shumë të mëdha të hollash. Në të njëjtën kohë, për shkak të qarkullimit të pakontrolluar të automjeteve nga ajo pjesë e Kosovës, edhe siguria po cenohet. Pyes ministrin Rexhepi: Çka po ndërmerr Qeveria e Kosovës dhe ju, në këtë rast, në lidhje me këtë problem? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Rexhepi, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë do të provoj më tepër të kufizohem në fushën që unë e mbuloj, megjithatë mund të jap edhe disa të dhëna edhe për çështjen e doganave, edhe pse kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Financave.

Të nderuar deputetë,  
Ministria e Punëve të Brendshme po vazhdon me angazhime të saj në drejtim të kthimit të sundimit të rendit dhe ligjit edhe në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Konsiderojmë se çështja e funksionalizimit të plotë të doganave të Kosovës në pikat kufitare Jarinje, që e quajmë pika 1 dhe Bërnjak, 31, i takon më tepër mandatit të EULEX-it, mision ky që vazhdon të angazhohet në këtë drejtim. Sa i përket regjistrimit të hyrje- daljeve të personave dhe automjeteve, një proces i tillë është duke u kryer. Është funksionalizuar plotësisht sistemi i kontrollit nëpërmjet sistemit Pajsis dhe regjistrimit të të gjitha hyrjeve -daljeve nga këto pikat e kalimit kufitar.

Në tremujorin e parë, në portën 1 ose Jarinje kemi pasur 9.591 hyrje të regjistruara dhe 8.138, dalje. Në portën 31 kemi pasur 8.361 hyrje dhe 7.668 dalje. Këto janë shifra të regjistruara nga Policia e Kosovës dhe ajo e EULEX-it në dy pikat e kalimit kufitar. Sa i përket procesit të kontrollit, Policia e Kosovës është e vendosur në këto pika dhe së bashku me Policinë e EULEX-it vazhdojnë të ushtrojnë mandatin e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi.

Të them se gjatë vitit të kaluar dhe këtë vit dukshëm është zvogëluar numri i kontrabandimeve që bëhen nëpërmjet këtyre pikave. Sa për informim, aty bëhet regjistrimi i automjeteve dhe i mallit dhe janë të obliguar të shkojnë në Terminalin doganor në Mitrovicë. Ndodhë që në sasi të vogla diku humbin gjatë rrugës, mirëpo është zvogëluar dukshëm evazioni fiskal, sidomos në të kaluarën, kur kanë pasur edhe përcjellje ndoshta edhe prej pjesëtarëve të policisë, ndërsa tash këto janë ndërprerë. Natyrisht që nuk jemi të kënaqur me këtë nivel, mirëpo kontrabandime ka edhe në pikat tjera kufitare, po për shkak të sensitivitetit, fokusimi ka qenë më tepër në veri dhe tash bashkëpunimet që i kemi me doganën, me Administratën Tatimore, çdo ditë rezultatet janë më të mira, por jo ato që i presim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, deputete?

TIME KADRIJAJ: Kur do fillojë të implementohet vendimi për ndalimin e qarkullimit të automjeteve me targa të Serbisë, vendim që ju vetë e keni marrë, zoti ministër. A paska qenë veç premtim parazgjedhor e jo premtim që në të vërtetë keni dashur ta realizoni? Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Sa i përket qarkullimit të targave të reja me inicialet e qyteteve të Kosovës, ju e dini që është marrë një urdhër, ai është në zbatim e sipër dhe nuk kemi qarkullim, përveç ndoshta në pjesën veriore aty- këtu, që nuk kemi qasje direkt, përndryshe urdhri është edhe më tutje në zbatim e sipër. Sa i përket targave të

vjetra, e dini se në të kaluarën UNMIK-u në çdo 6 muaj e ka shtyrë validitetin e atyre targave, ndërsa Qeveria e Kosovës, në vitin 2008, në prill, ka marrë një vendim që lejon qarkullimin deri në një vendim të ardhshëm të Qeverisë. Ne kemi diskutuar edhe në Bordin bashkërendues për sundim të rendit dhe të ligjit. Plani është i përgatitur, e kemi dorëzuar, por unë shpresoj për mbledhjen e ardhshme të Qeverisë do të jetë pikë e rendit të ditës dhe duhet të merret vendimi i Qeverisë. Mos të hyjë më tepër në detaje, në momentet që merret vendimi i Qeverisë, që jep afat për sa muaj duhet të ndërpritet, ne prapë do të vazhdojmë të njëjtën mënyrë, pra atë ditë që skadojë mandati i tyre, do të konfiskohen të gjitha dhe nuk do të lejohet qarkullimi i tyre. Kjo nuk është fushatë, por janë çështje konkrete. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetja e dytë dhe e fundit është e deputetit Bali Muharremaj, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi, kryeministri nuk është këtu. Keni të drejtë ta lexoni pyetjen. Dëshironi ta lexoni apo dëshironi ta shtyni pyetjen? Deputetit Muharremaj fjalën!

BALI MUHARREMAJ: I nderuar, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pyetja është për kryeministrin e Kosovës.

Më 4 prill 2011, kryetari i komunës së Therandës, zoti Blerim Kuçi është burgosur nga EULEX-i, për refuzim të dhënies së dëshmisë në një proces hetimi. Pas reagimit të AAK-së, komunës së Therandës, Asociacionit të komunave dhe të shoqatave të dala nga Lufta, ne nuk kemi parë asnjë reagim nga Qeveria e Kosovës e as nga subjektet tjera politike në vend.

Pyetja është: Çka duhet t'i ndodhë një kryetari komune, i cili ka qenë komandant gjatë Luftës Çlirimtare, për të merituar reagimin e kryeministrit të Kosovës? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kuçi do të përgjigjet në emër të kryeministrit.

HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit!

Unë do të provoj ta jap përgjigjen, por kisha dashur që ju para se ta bëni pyetjen, të pyetni në partinë e juaj se çka ka bërë Qeveria për rastin e kryetarit, pastaj do të jepja përgjigjen unë. Por, sido që të jetë, është krijuar një përshtypje në këtë vend, që një deklaratë e dhënë publikisht apo një reagim e përfundon punën e Qeverisë. Është pak metodë e viteve të sistemit paralel kjo, ta lëshosh një deklaratë dhe të shkosh në shtëpi. Qeveria ka punuar për rastin e Blerim Kuçit dhe unë po i shoh njerëzit në sallë që unë kam punuar për ta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje tjera nuk ka. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31 mars dhe 7 prill 2011**

Nëse keni vërejtje në procesverbale, të nderuar deputetë ju ftoj që ta thoni. Nuk ka. Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 31 mars dhe 7 prill 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

### **4. Formimi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës**

Në bazë të Rezolutës së miratuar nga Kuvendi, më 7 prill 2011, kryetarët e grupeve parlamentare i kanë propozuar Kuvendit formimin e dy komisioneve:

- Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe
- Komisionin për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Tani, nuk di a ka nevojë që përfaqësuesit, propozuesit..., apo të fillojmë me grupet parlamentare të bëjnë propozimet e tyre, sepse është ideja që të ftohet përfaqësuesi i propozuesve. Mund ta merrni fjalën, nëse dëshironi, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht duke mos dëshiruar t'ua marrë kohën, meqenëse e keni edhe materialin, ajo që u lexua nga kryesuesi është që, pas Rezolutës së miratuar kanë dalë obligimet për formimin e këtyre dy komisioneve dhe pas takimit që e kemi pasur më 13 prill, kryetarët e grupeve parlamentare, dhe me plotësimin me emra, më 15 prill, ne e dërguam kërkesën dhe Kryesia e ka miratuar që të jetë në rend dite sot dhe padyshim që është interesi edhe i qytetarëve, i të gjitha subjekteve politike që këto komisioneve të formohen dhe të bëhen këto ndryshime që janë të nevojshme, në mënyrë që atje ku ka pasur evidencë për lëshime dhe të meta, këto të bëhen nëpërmes përmirësimit të infrastrukturës në një mënyrë ligjore, duke filluar nga akti më i lartë shtetëror, siç është Kushtetuta. Andaj, besoj, meqenëse është pëlqimi i të gjitha grupeve, ky propozim, gjegjësisht këto dy komisioneve sot do ta marrin votën e deputetëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryesues!

Nuk kam asnjë vërejtje, vetëm desha t'i informoj të gjithë kolegët se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i bën dy zëvendësime në komisionet parlamentare.

Në Komisionin për Reformën Zgjedhore, në vend të Behar Selimit, ku e keni në material, zëvendësohet me deputetin Xhavit Haliti, dhe në Komisionin për Legjislacion, në vend të Arsim Bajramit, si kryesues i parë i këtij komisioni që ishte, caktohet Behar Selimi. Pra, Behar Selimi do të jetë nënkryetar i dytë i Komisionit për Legjislacion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve tjera parlamentare, a donë të flasin? Zoti Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

Është e qartë që lëvizja “Vetëvendosje”, prej se ka hyrë në fuqi kjo Kushtetutë e Kosovës, ka thirrur për ndryshimin e saj, edhe ndryshimin substancial të kësaj Kushtetute për shkak se përherë e kemi parë këtë Kushtetutë të jetë në kundërshtim absolut me vullnetin politik dhe interesat e popullit të Kosovës dhe për shkak se e kemi parë që kjo Kushtetutë është tepër e ngushtë e tepër kufizuese për këtë vullnet dhe për aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës.

Pra, ne kemi qenë si subjekt dhe vazhdojmë të jemi më të zëshmit në kërkesën tonë për ndryshimin e Kushtetutës, ndërkohë që për sa i përket Ligjit për zgjedhjet dhe procesit të zgjedhjeve në përgjithësi këtu në Kosovë, është evidente që të gjithë faktorët edhe nga shoqëria, por edhe nga politika pajtohen se ai duhet të ndryshohet dhe ai duhet të përmirësohet dhe kjo gjë është një gjë shumë normale, pra Ligji zgjedhor duhet përherë të jetë i përmirësueshëm, në mënyrë që të kemi proces zgjedhor sa më të drejtë dhe sa më të mirë për qytetarët.

Ne konsiderojmë që kjo çështje nuk iu takon vetëm forcave politike, por më shumë u takon të gjithë faktorëve shoqëror në Kosovë për shkak se, sikur zgjedhjet, e veçanërisht Kushtetuta, janë dokumente dhe procese të cilat duhet t’i shërbejnë interesit të qytetarëve, interesit të popullit e jo vetëm interesit të subjekteve politike të cilat garojnë në këto zgjedhje.

Ndryshimi i Ligjit për zgjedhjet është obligim institucional dhe ai duhet të shkojë nëpër rrugën normale, nëpërmjet mekanizmave ekzistues, që në këtë rast është Komisioni për Legjislacion, apo eventualisht përmes krijimit të një nënkomisioni ad-hoc, i cili do të merrej me këtë çështje. Mirëpo, këtu po shohim se në bazë të marrëveshjes së arritur nga dy parti politike, krejt ky proces është shtrembëruar dhe disi i është dhënë një kahe tjetër, kahja e krijimit të dy komisioneve të reja vetëm për këtë çështje, vetëm për shkak të marrëveshjes. Ne konsiderojmë që, po ashtu duhet të përmend që nuk ka qenë Ligji për zgjedhjet faktori kryesor i manipulimit dhe i keqpërdorimit dhe vjedhjes së votave më 12 dhjetor dhe gjatë muajit janar, por pikërisht ka qenë shkelja e Ligjit ajo që e ka mundësuar këtë vjedhje dhe në këtë drejtim, format tjera të marrëveshjeve të politikës dhe parapolitikës janë bërë si kjo tani për të cilën po..., nga e cila dalin këto dy komisione. Kanë vetëm interesat e ngushta të disa grupeve për bazë dhe jo domosdoshmërisht edhe përmirësimin, si të them ashtu, të atmosferës zgjedhore në Kosovë.

Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron që është tejet e dobishme që të merret pjesë në këto komisione, pavarësisht që nuk pajtohem me mënyrën si kanë ardhur këto dhe pavarësisht që nuk pajtohem me këtë procedurë se si po vazhdohet për këto dy ndryshime shumë të rëndësishme për Kosovën, për shkak se çështjet që do të diskutohen aty dhe çështjet për të cilat do të merren, me punën me të cilën do të merren këto komisione, janë çështje të rëndësishme jetike. Mirëpo, prapë duhet ta përmendi që po që se ndryshimi i Kushtetues të Kosovës, që do të dalë nga ky komision, përfundon vetëm në ndryshimin e mënyrës se si zgjedhet presidenti i Kosovës, atëherë vërtetë ky komision nuk ka bërë asgjë dhe nuk iu ka sjellë kurrfarë dobie qytetarëve të Kosovës.

Ndryshimet të cilat i nevojiten Kushtetutës së Kosovës janë ndryshime thelbësore, të cilat e shndërrojnë atë në një kushtetutë të një shteti sovran, pra në një akt më të lartë juridik të vendit, i cili është përmbi të gjitha dokumente tjera, e jo siç është kjo Kushtetuta aktuale nën planin e Ahtisarit. Pra, lëvizja “Vetëvendosje” do të marrë pjesë në këto komisione me anëtarët e përcaktuar për shkak të rëndësisë së tyre dhe për shkak të rëndësisë së lëndës të cilën ato e trajtojnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re e mbështesim themelimin e këtyre dy komisioneve dhe, natyrisht, me përbërjen e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj -Bujupi, me kartelë të Ahmet Isufit, ju lutem!

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do t’i japë, do të thotë, propozimet e veta me shkrim, sepse veç besoj i kemi paraqitur. Mirëpo, unë e kam kërkuar fjalën sot në një cilësi tjetër, në emër të grave deputete, me një kërkesë që Bordi i Grave të përfaqësohet në këto dy komisione, me qëllim të dhënies së kontributit rreth kriterëve gjinore, të cilat duhet të parashihen me këtë rast në ndryshimet që do t’i bëjmë. Prandaj, kërkojmë që të keni parasysh si Kryesi e Kuvendit, që në të dy këto komisione të jemi të përfaqësuara përmes bordit, i cili është mbipartiak dhe do të punojë në interesa të përgjithshme të standardeve dhe të kriterëve gjinore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të gjithë jeni në grupet parlamentare, të gjithë përmes grupeve të juaja mund të jepni vërejtjeje dhe mendoj që në qoftë se ka nevojë për të formuar OJQ, ne formojmë prapë, ka boll në Kosovë.

Nuk ka në emër të grupeve të tjerë të paraqitur. Deputetë të tjerë a ka që dëshirojnë ta marrin fjalën? Nuk ka. Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozimit për formimin e

Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Në sallë janë 91 deputetë. Komisionet, po dihet që është Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisioni për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, sipas marrëveshjes së bërë dhe sipas Rezolutës në Kuvend.

Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Ju faleminderit! “Për” kanë votuar 76 deputetë, “kundër” 6, 4 kanë abstenuar. Me këtë konstatoj që Kuvendi miratoi të dy komisionet e propozuara me Rezolutë dhe sipas marrëveshjes në Kuvendin e Kosovës. Pra, miratohet Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisioni për amendamentimi e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

## **5. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës**

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Panelit të Bordit të Bankës Qendrore për për zgjedhjen e kandidatëve për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për zgjedhjen e njërit prej 2 kandidatëve të propozuar. Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadregjonaj, të paraqesë raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të ndragur kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 13 prill 2011, ka shqyrtuar propozimin e Panelit të Bankës Qendrore për zgjedhjen e kandidatëve për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ka vlerësuar se Paneli i Bordit të Bankës Qendrore, me rastin e propozimit të kandidatëve për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës ka respektuar dispozitat procedurale të parapara me nenin 38 të Ligjit të Bankës Qendrore të Kosovës sa i përket shpalljes së konkursit, intervistimit dhe zgjedhjes së kandidatëve në bazë të kualifikimeve dhe performancës së treguar, për çka është dhënë edhe shpjegimi me shkrim, i cili i është bashkangjitur materialit të cilin e kemi shqyrtuar.

Komisioni, pas analizës së biografive të prezantuara të kandidatëve, ka vlerësuar se kandidatët e propozuar nga Paneli i Bordit të Bankës Qendrore, zoti Gani Gërguri dhe zoti Safet Merovci, i përmbushin kriteret formale juridike, të parapara me nenin 40 të Ligjit nr. 03-L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për t'u zgjedhur guvernator të Bankës Qendrore, ku parashihet që personat që kualifikohen për t'u zgjedhur, që të shpërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore, duhet të jenë me integritet dhe të kenë diplomë universitare, si dhe të kenë të paktën 10 vjet përvojë

profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, të financave, të bankave, të kontabilitetit apo të çështjeve juridike. Gjithashtu, komisioni ka vlerësuar se nga propozimi i cili është ofruar, kandidatët nuk kanë ndonjë pengesë, si parashihet në paragrafin 2, 3 dhe 4 të nenit 40, që të kualifikohen për t'u zgjedhur në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore, në këtë rast guvernatori i Bankës Qendrore.

Në bazë të nenit 38.2 të Ligjit nr. 03-L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Qeveria mund të japë një mendim Kuvendit për kandidatët e propozuar nga Paneli i Bordit të Bankës Qendrore, me kusht që ky mendim të dërgohet brenda 15 ditëve në Kuvend. Kuvendi nuk ka pranuar ndonjë mendim nga Qeveria brenda afatit ligjor lidhur me propozimin e Panelit të Bordit të Bankës Qendrore.

Komisioni, me shumicë votash ka miratuar këtë propozim dhe i ka rekomanduar Kuvendit të përzgjedhë njërin prej kandidatëve të propozuar nga Paneli i Bordit të Bankës Qendrore, si kandidat për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, në bazë të nenit 38.2 të Ligjit numër 03-L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës t'i përcillet Presidencës për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sipas radhës, përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryesues!  
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i mbështet rekomandimet e komisionit dhe do të marrë pjesë në votim për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Po, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të marrë pjesë në votim lidhur me kandidaturat, gjegjësisht kandidaturën për guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar "Vendvendosje", deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
Anëtarët e Panelit, të cilët i kanë intervistuar kandidatët për postin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, kanë vlerësuar në bazë të këtyre kriterëve: integriteti, kualifikimet akademike, praktika dhe eksperiencia relevante në punë, njohuritë mbi Bankën Qendrore, aftësitë udhëheqëse, eksperiencia dhe aftësitë menaxheriale, aftësitë e komunikimit dhe njohuritë mbi gjuhën angleze. Mendoj që ne, si deputetë të Kuvendit të Kosovës, duhet të kemi pikë së pari një raport të zgjeruar e të hollësishëm për secilin kandidat që është eliminuar qysh në fillim, pa na i treguar asnjëherë arsyet, sepse 27 veta gjithsej janë intervistuar dhe nuk po tregohet se si

konkretisht janë eliminuar të tjerët nga kandidimi dhe nga sjellja e tyre para Kuvendit të Kosovës për t'u zgjedhur.

Në anën tjetër, njësoj si me rastin e kandidatëve për president të Republikës së Kosovës, ne sërish nuk e dimë se çfarë e kanë ndërmend të bëjnë kandidatët...

**KRYESUESI:** Lus deputetët, mos u largoni se kemi për të votuar!

**ALBIN KURTI:** ... njësoj si me rastin, pra, të kandidatëve për president të Republikës së Kosovës, ne sërish nuk e dimë se çfarë e kanë ndërmend të bëjnë këta kandidatë të përzgjedhur nga Paneli, nëse zgjedhen nga Kuvendi. I kemi CV-të e tyre që përshkruajnë përvojën dhe aftësitë, por nuk e kemi vizionin dhe as programin e tyre. Aftësitë, sado të shkëlqyeshme, përderisa janë pa vizion, në rastin më të mirë janë aftësi për mbijetesë të suksesshme dhe jo për sukses që do të mbijetojë. Ne, si deputetë të Kuvendit të Kosovës, sot do të duhej të zgjedhnim një të ardhme në formën e njërit prej dy programeve, me ç'rast e kaluara e kandidatëve reflekton në besueshmërinë tonë për kandidatët në zotimin e tyre para nesh, e jo të zgjedhim njërën prej të kaluarave në formën e biografive të kandidatëve dhe të mbesim veç se me shpresë për të ardhmen.

Ne sot nuk dimë asgjë se çfarë kanë ndërmend të bëjnë këta kandidatë tash pra se të zgjedhen, sepse vetëm pasi të zgjedhen, ata mbajnë fjalim, i cili është kryesisht ceremonial dhe jo përmbajtësor, ose japin intervista për media. Neve po na tregohet teknikisht e kaluara e kandidatëve, pa na treguar ata se çka mendojnë të bëjnë në të ardhmen. Para se të dëgjojmë fjalimin e të zgjedhurit, duhet të dëgjojmë fjalimet e kandidatëve që duan të zgjedhen. Kandidatët do të duhej të na tregojnë se si mendojnë ta përdorin postin e tyre për të mirën e Kosovës. Ata duhet të prezantojnë se cilat do të jenë konkretisht operacionet e Bankës Qendrore nën udhëheqjen e tyre dhe si do ta përmirësojnë administrimin dhe menaxhimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 2.2 i Ligjit për Bankën Qendrore thotë se Banka Qendrore ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Si do të ruhet kjo autonomi konkretisht, nuk shkruhet nëpër CV-të e kandidatëve. Neni 7.1 thotë që objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbaj një sistem financiar stabil, ndërsa neni 7.2 thotë që Banka Qendrore kontribuon në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore. Si mendojnë ta bëjnë këtë secili prej kandidatëve? Çka do të bënin ndryshe prej asaj që është bërë deri më tash? A mendojnë që Banka Qendrore duhet të ndërhyjë në rregullimin e sistemit bankar të Kosovës për të përmirësuar kreditimin e ekonomisë nga bankat. Ne do të votojmë sot, pa e ditur asnjërin prej këtyre përgjigjeve dhe jo vetëm kaq. Këta kandidatë do të votohen pa na treguar se çka mendojnë ata për këto tri vitet e kaluara të Bankës Qendrore. Këta dy kandidatë kërkojnë të votohen pa na treguar se çka mendojnë për punën e ish - guvernatorit e Hashim Rexhepi dhe aferën e tij, sidomos kur njëri prej kandidatëve ka qenë zëvendës i tij. Këta dy kandidatë kërkojnë që të votohen pa na treguar se çka mendojnë për autoritetin qendror bankar të Kosovës, si paraardhëse e Bankës Qendrore dhe të cilat janë përgjithësisht të mirat e të këqijat nga kaluara, e si do të duhej të ecim përpara.

Po ashtu, këta kërkojnë të votohen pa na treguar se si do të jetë roli i Bankës Qendrore, si bankier, këshilltar financiar, agjent fiskal, depozitar dhe arkëtar për Qeverinë. Kjo e fundit, njëmend përshkruhet shkurtimisht në nenet 30 dhe 31 të Ligjit për BQK-në, por në rrethanat aktuale e konkrete të veçanta, sigurisht që kërkojnë veprime konkrete dhe të veçanta, që ne nuk i dimë. Përderisa ne nuk e dëgjojmë e lexojmë se çka kanë ndërmend të bëjnë këta kandidatë, në fakt zgjedhja nuk është e këtij Kuvendit, por e Panelit që i solli këta kandidatë në Kuvend.

Krejt çka realisht kemi para vetes, është që njëri kandidat i ka 91 e tjetri 85 pikë, nga totali prej 100 pikësh, sipas vlerësimit të Panelit. Me këtë mënyrë, nuk po zgjedh Kuvendi, por vet Paneli dhe, natyrisht, ICO-ja, Zyra Civile Ndërkombëtare, pra, e cila jo vetëm që ndodhet sipër Kuvendit, duke pasur të drejtë që t'i shfuqizojë ligjet dhe vendimet e Kuvendit, por ndodhet edhe para këtij Kuvendi, sepse i heq nga lista edhe kandidatët që i kalon Paneli, siç ishte rasti me heqjen e Gani Lubotenit, më falni, Gazmend Lubotenit! Pra, Zyra Civile Ndërkombëtare, ICO-ja po ndërhyrë edhe para se një çështje të vijë në Kuvend, përveç se gjithmonë mund të bëjë këtë edhe pasi që kjo çështje të jetë vendosur në Kuvend. Zyra Civile Ndërkombëtare hapur ka marrë anën e njërit kandidat. Ndonëse ky anim mund të jetë për të mirë, ai kurrësi nuk është i drejtë.

Gjithashtu, për këta dy kandidatë është evidente se në rastin e zotit Gërguri, vërehet se të gjitha pozitat ose trajnimet që i ka kryer, kanë qenë të mundshme vetëm për arsye se ai ka vendosur kush ka mundur të shkojë e kush jo nga ato pozita që i ka mbajtur ai vet në Bankën Qendrore, kurse te Safet Merovci, shihet se ai nuk ka fare përvojë në çështjet e Bankës Qendrore.

Ne, deputetët e Kuvendit të Kosovës, duhet të votojmë për politika e për programe dhe jo për personalitete. Ne nuk do të duhej të legjitimojmë zgjedhjet e bëra paraprakisht, por duhet të bëjmë zgjedhje që do të jenë legjitime. Kjo praktikë që është bërë kulturë në këtë Kuvend, e dëmton llogaridhënien institucionale dhe kontribuon më pastaj në performancën e dobët të atyre që po zgjedhen më shumë sa për sy e faqe, se sa për mendjet dhe idetë që kanë. Prandaj, rrjedhimisht, qëndrimi ynë është që, në fakt, këtu jemi thirrur që të legjitimojmë e jo të zgjedhim, prandaj e vetmja zgjedhje e drejtë është të zgjedhim duke mos e votuar asnjërin prej këtyre dy kandidatëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës do të marrë pjesë në votim për guvernatorin e Bankës së Kosovës në përputhje me ligjet dhe Rregulloren e Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re do të marrë pjesë në votim për guvernatorin e Bankës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të tjera grupe, nuk ka të paraqitur. SLS-ja, a dëshiron ta marrë fjalën? Deputeti Rashiq.

SAŠA RAŠIĆ: Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je podržala i prihvata preporuke od strane Komisije za budžet i finansije, učestvovala u glasanju za kandidate, odnosno za guvernera Centralne banke Kosova.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Parlamentarna grupa „6+“ uzeće učešće u glasanju guvernera za Centralnu banku Kosova.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet që në emër të grupeve janë paraqitur dhe janë ezauruar fjalët. Është i paraqitur deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrat, zëvendësministrat!

Sot e zgjedhim vazhduesin e politikave të njëjta të Bankës Qendrore, guvernatorin ose zëvendëshefin e ish-guvernatorit Hashim Rexhpi, me politika të njëjta që ka vazhduar dhe vazhdon edhe tash.

Unë mund të falënderoj Piter Feit që na ka sugjeruar me një letër neve deputetëve kë ta zgjidhim që është i përshtatshëm. E falënderoj po ashtu Piter Feit që thotë që duhet ta zgjidhni Gani Gërgurin sepse është më i merituari, sigurisht për ta. Por, unë do të prezantoj disa të dhëna tjera nga një opinion personal që këshilltarët e ICO kanë tejkaluar kompetencat me ruajtjen me çdo kusht të konfidencialitetin, që e kanë quajtur, për strukturën e bankës për shkak të shkëlqeve, të keqpërdorime që janë bërë. Këtu kemi të dhënat se, kush e ka lexuar edhe “Kohën ditore” e ka parë për zotin Salihu, zotin Shreder, thotë janë implikuar vazhdimisht me 15 milionë euro në Bankën Kreditore të Prishtinës dhe të nejtut njerëz kanë vlerësuar që duhet të zgjedhen personat e njëjtë, të vazhdohet politika e njëjtë, të mbulohen keqpërdorimet në Bankën Qendrore që i ka bërë Hashim Rexhepi, bashkë me Gani Gërgurin. Sjellja e tyre është jo e drejtë, jo e mirë, jo e mirëpritur. Prandaj, në ndërkohë, për shembull, ky Kapusella, që është një punëtor aty, ka marrë pjesë dhe ka qenë drejtues i bordeve të ndryshme, të ndërmarrjeve publike: në PTK, në Aeroport, e tjerë e tjerë dhe ku janë evidentuar humbje dhe humbje. Unë mendoj që edhe kërkohet që nga ky Kuvend të kthehet edhe një herë konkursi, të rihapet konkursi i ri, të zgjidhen njerëz të ri që do të ndryshojnë politikat e Bankës Qendrore, nëse duam investim dhe ndërtim.

Përndryshe, ne vazhdojmë avazin e vjetër, krimin e organizuar që e ka instaluar guvernatori i kaluar dhe në të ardhmen do ta kemi po ashtu krimin e instaluar në Bankën

Qendrore, e që do t'i shtrijë rrënjët e veta deri në porët e çdo vendi. Prandaj, kërkoj edhe një herë që nga deputetët mos ta pranojnë votimin, por të kërkojmë t'i kthehet ky Qeverisë, t'i kthehet Bankës Qendrore, ta hapin konkursin e ri dhe ta bëjmë një zgjedhje më të mirë për të ardhmen, nëse duam ta kemi një bankë me duar të pastra, nëse jo, duart e krimit janë në Bankën Qendrore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Zoti Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,  
Kolegë deputetë,  
Ne kemi sot përpara zgjedhjen e një funksionari shumë të rëndësishëm të një lëmie të jetës ekonomike në Kosovë dhe për veten time jam tepër i befasuar me mënyrën se si shefat e grupeve u prononcuan sot këtu. Unë kam respekt për "Vetëvendosjen", e cila shprehu pikëpamjet e veta, megjithëse duke mos u përcaktuar, faktikisht u përcaktua çka bën. Sido që të jetë, më lejoni që të kujtoj si është zgjedhur ai guvernator, që ka shkuar qysh ka shkuar këtu. Atëherë ka pasur një diskutim shumë substancial, ka dalë ajo që kanë thënë deputetët, kanë pasur të drejtë, një shumicë e ka imponuar dhe ka shkuar. Mendoj se duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm kur bëjmë votime të tilla dhe mos të bisedohet përtej këtyre bankave. Në opinion është e drejtë e njerëzve të shprehin opinione publike në gazeta, por të tregojnë këtu çka mendojnë në Kuvend. Mendoj që është tepër enigmatik prononcimi i partive politike - ne do të marrim pjesë në votim, thua ti që po zgjedhet kushdo qoftë.

Duhet të argumentohet kush çka do para se të votohet, se edhe votimin, ne do të vendosim a do ta bëjmë të fshehtë apo do ta bëjmë jo të fshehtë. Tash do të vendosim, pak pas kësaj, kështu që nuk është mirë të mos bisedohet esencialisht për këta dy kandidatë. Unë nuk po kërkoj që të deklarohen njerëzit, por dua të tërheq vëmendjen që Kuvendi, nëse e zgjedhë, ka detyrim që të jap mendimin e vet, të mos na ndodhë si herën tjetër, se herën tjetër në këto banka është thënë që për këtë e këtë arsye ai guvernator nuk duhet të zgjidhet, ai është zgjedhur dhe mandej historitë dihen. Është zgjedhur. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit!  
Të nderuar deputetë,  
Meqë janë të propozuar dy kandidatë për pozitën e guvernatorit, ndërsa me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes, propozoj që votimi të jetë i fshehtë.

Lus deputetët që të deklarohen për formën e votimit, a jemi për votim të fshehtë apo jo?

Votojmë tani, me elektronikë votojmë. Votojmë "për", "kundër" ose abstenim.  
Votojmë tani:  
Atëherë, konstatoj që votimi bëhet në mënyrë të fshehtë për dy kandidatët, 59 vota janë "për", 5 "kundër", 1 abstenim.

Lus për zbatimin e procedurës së votimit. Kabinat janë të gatshme. Kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, në mbështetje të zyrtarëve të

administratës. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues.

Në emër të PDK-së, kush propozon? Nuk është kryetari. Kush e do fjalën për propozim? Hajde Adem, kë e propozon për Komision votues?

ADEM GRABOVCI: Propozojmë Berat Buzhalën.

KRYESUESI: Nuk është.

ADEM GRABOVCI: Ramiz Lladrovcin.

KRYESUESI: Nga LDK-ja, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI:; Unë propozoj zotin Hashim Desushku.

KRYESUESI: “Vetëvendosja”.

VISAR YMERI: Propozoj Alma Lamën.

KRYESUESI: AAK-ja, Ardian.

ARDIAN GJINI: Bali Muharremaj.

KRYESUESI: Koalicioni Kosova e Re, Ibrahim.

IBRAHIM MAKOLLI: Deputeten Sevdije Lama.

KRYESUESI: SLS-ja? Rashiq.

SAŠA RAŠIĆ: Samostalna liberalna stranka, odnosno Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke predlaže Gorana Marinkovića za člana ove komisije.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”?

RASIM DEMIRI: Albert Kinolli.

KRYESUESI: Lus deputetët për një miratim formal të këtij komisioni. Votojmë tani. Në rregull është, kundër nuk ka, një është “kundër”. Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Lus komisionin që të fillojë me procedurën, ndërsa deputetët i ftojme të votojnë sipas listës.

Ne nuk kemi marrë pauzë, të nderuar deputetë, nuk e di ku po shkoni. Unë nuk e di ku po shkoni, nuk ka pauzë. Do të fillojmë votimin, nuk ka pauzë. Ata që nuk janë, do të konsiderohen se nuk kanë votuar, e për mosvotim...

Regjia, ju lutem që t'i bini ziles dhe t'i thirrni deputetët në sallë! Nuk kemi marrë pauzë. Askush nuk ka kërkuar pauzë, asnjë grup parlamentar dhe unë nuk po ju kuptoj pse keni dalë jashtë.

Lus deputetët që të bëhen gati për procedurën e votimit, të cilën do ta fillojmë menjëherë. Ftoj për votim deputetin Adem Grabovci. Zoti Grabovci, keni për të votuar. Ata që nuk janë në komision, nëpër vende!

- Aferdita Berisha – Shaqiri,
- Afrim Hoti,
- Afrim Kasolli,
- Gezim Kelmendi,
- Agim Kuleta,
- Ahmet Isufi,
- Albana Fetoshi,
- Albana Gashi,
- Albin Kurti,
- Albulena Haxhiu, nuk është,
- Ali Sadriu,
- Albert Kinolli,
- Alma Lama,
- Anton Quni,
- Arben Gashi,
- Ardian Gjini,
- Armend Zemaj,
- Aurora Bakalli,
- Azem Syla,
- Bahri Thaçi,
- Arsim Bajrami,
- Bali Muharremaj ,
- Berat Buzhala, nuk është,
- Behar Selimi, nuk është,
- Amir Ahmeti,
- Bekim Haxhiu,
- Biserka Kostiq,
- Blerim Shala,
- Blerta Deliu-Kodra, nuk është,
- Burim Ramadani,
- Danush Ademi,
- Daut Haradinaj,
- Donika Kadaj –Bujupi,
- Duda Balje,
- Elmi Reçica,
- Emilija Rexhepi, nuk është sot,
- Enis Krvan, nuk është,
- Nait Hasani, nuk është,

- Eqrem Kryeziu,
- Etem Arifi, nuk është,
- Fadil Demaku,
- Fatmir Limaj, nuk është,
- Fatmir Xhelili,
- Jeton Svirca, nuk është,
- Flora Brovina,
- Florin Krasniqi,
- Ganimete Musliu,
- Glauk Konjufca,
- Goran Marinkoviq, në komision

Daut, hajde voto se ke harruar, të kemi thirr, nuk ke qenë këtu, mëditjen e ke të humbur.

- Niazi Idrizi,
- Haki Demolli,
- Halit Krasniqi, nuk është,
- Hamza Balje,
- Hydajet Hyseni,
- Hashim Deshishku,
- Hasime Krasniqi,
- Hykmete Bajrami,
- Ibrahim Makolli,
- Idriz Vehapi,
- Imri Ahmeti,
- Ismet Beqiri,
- Jakup Krasniqi, nuk është,
- Jasmina Zhivkoviç,
- Nait Hasani. Nait, a do të votosh, se pak më parë s'ishe këtu?
- Jelena Bontiq,
- Justina Pula,
- Kymete Bajraktari,
- Latif Gashi, nuk është,
- Liburn Aliu,
- Lirije Kajtazi,
- Lumnije Morina,
- Lutfi Haziri,
- Lutfi Zharku,
- Fikrim Damka,
- Kurtan Kajtazi,
- Suzan Novobrdaliu,
- Mufera Shinik,
- Muhamet Mustafa,
- Murselj Haljilji,
- Myzejene Selmani,
- Naser Osmani,

- Nazane Breca,
- Nekibe Kelmendi, nuk është,
- Sasha Milosavljeviq,
- Petar Miletqi,
- Rada Trajkoviq, mungon,
- Ramë Vataj,
- Ramiz Kelmendi,
- Ramiz Lladrovci,
- Rasim Demiri,
- Rexhep Selimi,
- Rita Hajzeraj,
- Sabri Hamiti,
- Sadri Ferati, mungon,
- Safete Hadërgjonaj,
- Sala Berisha-Shala,
- Sali Asllanaj,
- Salih Morina,
- Salihe Mustafa,
- Sasha Djokiq,
- Sasha Rasiq,
- Sevdije Lama,
- Shaip Muja,
- Skender Hyseni,
- Boban Todoroviq,
- Sreten Ivanoviq,

Ju deputetë, në mes veti nuk është mirë të dilni në lozhë e të na bëni zhurmë. Nuk lejohet të flisni me lozhën, ju lutem, deputetë! Ose rrini në sallë, ose dilni në kafe, bëni muhabet. Ne dozvoljava se razgovor u loži!

- Teuta Haxhiu, nuk është,
- Teuta Sahatqija,
- Time Kadrijaj,
- Ukë Rugova,
- Vesimir Saviq,
- Vesna Mikiq, s'është,
- Visar Ymeri,
- Vjollca Krasniqi,
- Vjosa Osmani, nuk është,
- Valbona Dobra,
- Xhevahire Izmak, mungon,
- Xhevdet Neziraj,
- Zenun Pajaziti,
- Xhavit Haliti.

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Në ndërkohë janë këtu edhe Mufera Shinik dhe Fikrim Damka dhe i thërras që të votojnë. Edhe Enis Kervan!

(Ndërprerje e incizimit)

Komisioni, vazhdoni! Regjia, kyçeni mikrofonin!

ALMA LAMA:

- E pavlefshme, vota e parë,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,

- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Safete Merovci,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Edhe kjo e pavlefshme, nuk është votuar asnjëri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Safet Merovci,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,

- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Safet Merovci,
- E pavlefshme,
- Safet Merovci,
- E pavlefshme,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Safet Merovci,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- Gani Gërguri,
- E pavlefshme,
- Edhe kjo e pavlefshme,
- Edhe kjo e pavlefshme.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Lus deputetët të ulën dhe të dëgjojmë raportin e Komisionit për votime. Urdhëroni!

ALMA LAMA: Atëherë, Komisioni votues për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më datë 22 prill 2011, konstatoi – raportoi rezultatin e votimit për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 pikë 2 të Ligjit Numër 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit,

Komisioni votues i formuar me vendim të seancës plenare, datë 22 prill 2011, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar:

- Ramiz Lladrovci, PDK,
- Hashim Deshishku, LDK,
- Alma Lama, “Vetëvendosje”,
- Bali Muharremaj, AAK,
- Sevdije Lama, AKR,
- Goran Markoviq, Grupi SLS, dhe
- Albert Kinolli, Grupi “6+”.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 22 prill 2011, konstatoi, si vijon:

- Në votim kanë marrë pjesë 99 deputetë;
- Për Gani Gërgurin kanë votuar 58 deputetë;
- Për Safet Merovcin kanë votuar 15 deputetë;
- Të pavlefshme janë 26 fletëvotime.

Në bazë të rezultatit të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 pikë 2 të Ligjit Numër 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se me shumicë votash u zgjodh guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, zoti Gani Gërguri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, për raportin e Komisionit!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të raportit të Komisionit votues, konstatoj se Kuvendi miratoi përzgjedhjen e zotit Gani Gërgurit për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Emërtimi i guvernatorit bëhet për mandatin e mbetur të guvernatorit të mëparshëm, që do të thotë deri më 26 mars 2013, sipas nenit 45 të Ligjit për Bankën Qendrore.

Në bazë të nenit 38 pikë 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, vendimi i dërgohet presidentes së Republikës së Kosovës për emërimin e guvernatorit.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

## **6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010**

Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010, e kanë shqyrtuar komisioni funksional dhe Komisioni për buxhet e financa dhe Kuvendit i kanë rekomanduar që ta miratojë.

Kryetari i komisionit funksional, zoti Idriz Vehapi e ka fjalën! Urdhëroni!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Në pajtim me nenet 62 pika 1, 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, si dhe nenit 3 pika 8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 21 mars 2011 vendosi që për Raportin vjetor të KPM-së 2010, Kuvendit t'i paraqet këtë:

## REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që të miratojë Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010.

Arsyetim:

Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur të Mediave, i vitit 2010, është i kompletuar dhe u përmbahet të gjitha kritereve të hartimit të një raporti.

Gjithashtu, Raporti i KPM-së tregon një performancë të mirë që është për t'u vlerësuar dhe miratuar. Faleminderit!

SABRI HAMITI: Faleminderit! Për Komisionin për Buxhet e Financa, zonja Safete Hadërgjonaj, kryetare e komisionit.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni i Pavarur i Mediave, në raportin të cilin e përgatit për Kuvendin është i obliguar që këtij raporti t'ia bashkëngjet edhe pjesën e raportit financiar, të cilin Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar.

Komisioni i Pavarur për Media, në bazë të nenit 16 pikë 3 të Ligjit për KPM-në, cakton një skemë për tarifat e licencës për kategori të ndryshme të licencave të transmetimit, që do të paguhet për çdo vit. Nga të licencuarit realizon të hyrat vetanake prej taksës së licencës nga subjektet transmetuese.

Në bazë të nenit 16 pikë 3, tarifat vjetore të licencave depozitohen në tërësi në një xhirollogari të KPM-së, që caktohet nga autoriteti qeveritar kompetent për çështje fiskale.

Në bazë të dispozitave të lartpërmendura, KPM gjatë vitit 2010 ka inkasuar 231.436 euro, prej të cilave 218.636 euro nga taksat për licencë, kurse 12.800 euro nga të hyrat nga gjoba.

KPM-së gjatë vitit 2010 iu ka miratuar buxheti me vlerë prej 1.115.000 euro, nga të cilat ka shpenzuar 1.064.000 euro, çka do të thotë se buxhetin e ka shfrytëzuar 95%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2011 ka shqyrtuar raportin financiar të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ka vlerësuar se raporti është në pajtim me nenin 3.8 të Ligjit Numër 02/L-15 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe transmetim dhe ofron të dhëna të detajizuara të shpenzimeve buxhetore dhe i njëjti i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë këtë raport financiar të KPM-së për vitin 2010. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Nuk kemi asfarë paraqitje për komente ose diskutim. Tash u çuat ju prej gjumi, a? Lirije Kajtazi!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E di se ndër sfida për Kosovën dhe demokracinë e saj është edhe fjala e lirë dhe monitorimi i saj, andaj e dimë që edhe ky komision ka mjaft punë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka analizuar me urti Raportin e Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2010 dhe ka parë të mirat dhe të metat në këtë raport.

Duke dashur të ndihmojë funksionimin e medias në Kosovë, Grupi Parlamentar ka dashur t'i besojë Komisionit të Pavarur për Media se shumë gjëra varen edhe nga disa pika, për të cilat Lidhja Demokratike e Kosovës do të ndihmojë me kapacitetet e saj, si vijon:

7. ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për KPM-në;
8. në Ligjin për RTK-në;
9. në Ligjin për të drejta autoriale, dhe
10. në disa ligje që prekin këtë fushë.
11. Po ashtu, të procedohet më shpejt në emërimet e Këshillit të Komisionit.

Ndër shqetësimet tona janë çështjet në tabelën e rasteve ligjore, të cilat në shumicën e rasteve edhe në rastin kur në Komisionin parlamentar është biseduar edhe për Raportin e RTK-së, janë përmendur si gjëra të cilat kanë të bëjnë edhe me: anën ligjore; shkeljet në kodin e sjelljes; operatorët ilegalë, e posaçërisht operatorët në veriun e Kosovës dhe, shumë me rëndësi, mbulueshmëria e territorit me televizionin publik, edhe kjo ka lidhje me operimet ilegale. Po ashtu, është shqetësues raporti financiar në të cilin do të flitet pak më shumë edhe nga folësit tjerë të grupit tonë.

Ne kemi dashur të besojmë në shqetësimet e Komisionit të Pavarur për Media, do të ishte mirë që ata të besojnë në gatishmërinë tonë dhe të korrigjojnë pjesën e cila ka mundësi të bëhet me ndihmesën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu, të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

U bënë tri vite që Kosova filloi ndërtimin e shtetit dhe ajo çka i duhet këtij vendi, është vërja e themeleve bazë demokracisë. E një ndër parimet kryesore është pikërisht liria e shprehjes, kodi i etikës në gazetari dhe informimi në Kosovë.

Ky raport ka ngërthyer në vete disa informata rreth aktiviteteve dhe shkeljeve të mediumeve të caktuara, mirëpo gjendja e vërtetë vazhdon të ketë shumë më shumë mangësi sa i përket lirive themelore të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe ndërhyrjeve të

vazhdueshme të politikës, përkundër reagimeve të shumta nga kjo foltore edhe rënies së reitingut në të gjitha raportet ndërkombëtare, ku Kosova për fat të keq është radhitur në vendet me më pak demokraci, për të mos thënë totalitare.

Veprimet në avancimin e lirisë së medias do të duhej të bëheshin me masa konkrete dhe jo vetëm me deklarata të Qeverisë, e cila gjatë konferencave zotohet që do të punojë në përmirësimin e gjendjes, ndërsa pas dite ndërhyrja politike redaktuese e kjo vërehet shumë shpesh në televizionet tona.

Që të arrihen objektivat e parapara me këtë raport, duke filluar nga digjitalizimi, zhvillimi i tregut medial, që do t'u shërbejë të gjithë gazetarëve të Kosovës, promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese, përveç angazhimeve të KPM-së, nevojitet edhe përkrahja e përgjithshme e institucioneve tona.

Mbi të gjitha, është domosdoshmëri urgjente që ato të jenë të pavarura, ndërkaq për të qenë në këtë nivel, duhet t'u krijohet hapësirë. Pse po e them këtë? Sot mediat në Kosovë, në mungesë të një financimi të pavarur varen nga politika, qeveria, besa edhe nga kompanitë e mëdha, të cilat zakonisht zbatojnë agjendat e veta dhe mbetet shumë pak hapësirë për një informim të paanshëm dhe të pavarur.

Prandaj, vazhdojmë të kemi media të varura nga politika, shumë herë edhe të kërcënuara si, për shembull, gazetarët që shumë pak paguhen e mos të them nuk stimulohen fare për të qenë gazetar hulumtues, ku një gazetari e tillë do të ishte mekanizëm i fuqishëm në luftimin dhe parandalimin e dukurive negative të cilat kanë zënë vend në Kosovë.

Prandaj, AAK konsideron që raporti është mirë i strukturuar, mirëpo gjendja reale e sferës së medias në Kosovë është larg dhe shumë më keq. Kosova vazhdon të ballafaqohet me ngulfatje të lirisë së medias, ndërhyrjet e vazhdueshme dhe jo rrallë edhe kërcënime ndaj gazetarëve.

Andaj, Grupi Parlamentar i AAK-së e miraton me vërejtjet dhe sugjerimet, siç i cekëm, dhe do të jetë çdoherë në funksion të vazhdueshëm të përmirësimit të kësaj gjendjeje, të bindur se Kosovës në shumë raste, më shumë se politika dhe politikanët, i duhen mediat e lira dhe të pavarura. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, Ibrahim Makolli nuk e do fjalën, por e do Petar Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovane kolege,

Govorim u ime Poslaničke grupe Samostalne liberalne stranke i želim da istaknem da je ovaj izveštaj Nezavisne komisije za medije mnogo bolji nego bilo koji pre do sada i ja želim da im čestitam na odličnom izveštaju, pre svega, i na tome što su bili izuzetno iskreni u svom izveštaju i priznali da u nekim delovima medijskog neba nisu zakonska rešenja do kraja ispoštovana.

Pre svega ja bih želeo da kažem par reči o delovima koji se tiču manjinskih zajednica, dakle pre svega o izveštaju javnog servisa, dakle RTK-a, koji ni u prošloj godini nije uspeo da ispoštuje zakonski minimum od 15% programa na jezicima manjina, ali ja bih pre svega rekao da čak ni to nije veliki problem zato što je, prema Izveštaju Nezavisne komisije za medije, 12% programa bilo na manjinskim jezicima, a po zakonu je 15%, međutim ja bih pre svega skrenuo pažnju na kvalitet programa koji se na RTK-a emituje.

Takođe, želeo bih da istaknem i ono što se desilo pre od prilike mesec dana, kada je prekinuta emisija koja se zove „Slobodno srpski“, a koja je emitovana na RTK-a, što je nedopustivo i potpuno neprofesionalno, pre svega. Ukoliko je ta emisija bilo šta emitovala a što nije u skladu sa politikom kuće, onda oni su trebali pre svega da pregledaju taj snimak, a ne da ga prekidaju u pola emisije.

Takođe, želeo bih da kažem da onaj deo koji govori o formiranju kanala koji će emitovati program na srpskom jeziku a imati pokrivenost na celoj teritoriji Kosova, da je taj deo izveštaja odličan i da sa ovog mesta i u ime Poslaničke grupe Samostalne Liberalne stranke pružamo i dalje podršku Radnoj grupi koju predvodi ambasador Nemačke i nadamo se da će tajming te radne grupe biti ubrzan. Naravno da je tu bilo i objektivnih razloga što se kasnilo jer znamo svi da nismo imali ni skupštinu ni vladu skoro šest meseci, ali prosto ja mislim da je vreme da ono što smo preuzeli kao obavezu, a to je ustavna obaveza da taj kanal u ovoj godini bude formiran i da počne sa radom.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Tash prapë e kemi edhe një deputete. Fjalën e ka Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në lidhje me këtë raport, ne kemi konstatuar që vërtet ka pasur shkelje nga mediat e ndryshme, mirëpo raporti vetëm sa i konstaton ato dhe gjithçka nuk duhet të mbetet vetëm në fazën e konstatimeve të shkeljeve të ndryshme. Kam parasysh sidomos çështjen e reklamimit, ku disa media nuk janë pajtuar me ligjin në fuqi. E kam fjalën këtu për median publike, e cila vazhdon të fusë reklama pavarësisht nga vendimi i KPM-së. Mendoj se gjërat duhet të çohen deri në fund, pra të shkohet me respektimin e ligjit, domethënë çështja duhet të shkojë deri në procedurat e mëtutjeshme, në çështje gjyqësore, në rast se ato nuk respektohen.

Kam edhe vërejtje të tjera, mirëpo ne si Grup i “Vetëvendosjes” mendojmë që është e rëndësishme që aktualisht ky raport të miratohet, por duke i dhënë këto vërejtje që sa po i thashë. Pra, është çështja e reklamimit, ndarja e hapësirës reklamore në mes të Televizionit publik dhe televizioneve private.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Nuk ka të tjerë deputetë që donë të diskutojnë. Urdhëro, Ali Sadriu! Po, paraqituni me kohë, more zotëri, se...!

ALI SADRIU: Po, tash po startojmë! Faleminderit, zoti kryesues!

Kam një vërejtje që në radhitjen e këtyre temave, është mirë të kemi parasysh që në raste kur kemi edhe raportime të auditorit, të përfshihen dhe të jenë pjesë përbërëse e këtij materiali.

Unë para vete e kam raportin. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike po ashtu është në proces të këtij raporti dhe këtu kam një sërë shkeljesh dhe parregullsish në veprimtarinë financiare të këtij institucioni.

Nuk është i vetëm ky, ka edhe të tjerë dhe unë mendoj se forma se si ne po procedojmë, realisht ne vetëm po konstatojmë dhe mandej ato po mbeten konstatime pa një efekt në procesin e riparimit të atyre dobësive, lëshimeve, keqpërdorimeve që japin edhe afëra korruptive.

Te raporti në fjalë, janë jo më pak se 11 vërejtje dhe rekomandime që janë dhënë në material nga auditori gjeneral, i cili është shumë kompetent dhe flet vetëm për sferën financiare. Një rast t'ua përkujtoj. Nga shërbimet kontraktuese, 95% janë financuar anëtarë të bordit dhe njerëz që punojnë në këtë institucion. Ka edhe lëshime tjera dhe unë iu propozoj atyre të cilët i krijojnë këto rende të ditës, këto materiale për shqyrtim, në raste kur ka material nga auditori gjeneral apo komisionet tjera, të jenë pjesë përbërëse e tij. Unë besoj se pos anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrje, ju të tjerët nuk i keni këto raporte. Po t'i kishit parë, sigurisht se do të kishit tjetër vlerësim.

Prandaj, kërkoj që në të ardhmen këto raporte duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij... sepse ai është institucion, atëherë shtrohet pyetja pse e mbajmë ne auditimin gjeneral, pse e kemi formuar Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nëse vazhdojmë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: A ka kush tjetër? Nuk ka. Unë vetëm një sqarim. Është çështje e deputetëve sa punojnë, por edhe raportet e agjencioneve, edhe raportet e komisioneve çdo deputet i merr në kuti me kohë. Kaq. A i lexojnë, a s'i lexojnë, a qysh i lexojnë, është problem i tyre. Më nuk ka diskutues.

Unë e vë në votim raportin.

Në sallë kemi 66 deputetë, të gjitha grupet rekomandojnë që të votohet dhe votojmë tash.

Me 50 vota “për”, 8 “kundër”, 4 “abstenime”, Kuvendi aprovon Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2010.

Kolegë të nderuar, vazhdojmë në orën 14:30. Faleminderit!

#### Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Atëherë, po vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2010.**

Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2010 e ka shqyrtuar Komisioni funksional dhe Kuvendit e ka rekomanduar, për miratim.

Sipas radhës, kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryesues!

Në bazë të nenit 120 të Ligjit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, Numër 02/L-241, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar të raportojë para Kuvendit të Kosovës. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me kohë e ka dorëzuar raportin, të cilin Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datën 6 prill 2011 e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka vlerësuar se raporti i përfshin informacionet të cilat i parasheh Ligji për aktivitetet e prokurimit.

Në raport janë paraqitur numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, numri i ankesave të refuzuara për shkak të mungesës së afateve kohore ose jo plotësisë sipas nenit 109 dhe 111 të Ligjit, dështimet për të depozituar sigurimin e kërkuar nga neni 118, numrin e ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme, numrin e aktiviteteve të prokurimit që janë anuluar si rezultat i një ankese, informatat e detajuara mbi çdo ngjarje ku autoriteti kontraktues ka dështuar në respektimin e një urdhërese të OSHP-së, numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme.

Raporti përmban edhe pjesën financiare, ku vërejmë se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pasur buxhetin në vlerë 344.341 euro, nga i cili janë shpenzuar 246.719 euro apo 71.64%.

Pasi që raporti i përmbush kriteret ligjore të parapara në dispozitat ligjore të prokurimit publik, komisioni i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010.

Zoti kryesues, për të mos marrë fjalën edhe një herë, nëse më lejoni, kisha dhënë edhe mendimin e Grupit Parlamentar të PDK-së?

**XHAVIT HALITI:** Vazhdo edhe për Grupin Parlamentar, se edhe ashtu e ke radhën.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Organit shqyrtues të prokurimit publik dhe është i mendimit se Raporti është sjellë me kohë dhe përfshin të gjitha çështjet që i parasheh Ligji i prokurimit publik për të raportuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka bërë punë të mirë në krijimin e marrëdhënieve të mira me publikun, në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe operatorëve ekonomikë për funksionimin dhe për shërbimet që i ofron ky organ shqyrtues.

Shqyrtimi i ankesave ka rritur interesin e operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesat kur ata dyshojnë që shkeljet e të drejtave të tyre që i gëzojnë sipas Ligjit të prokurimit publik, e njëkohësisht është rritur edhe besueshmëria ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë.

Kjo ka bërë që të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria për administrimin e fondeve publike dhe njëkohësisht krijimin e kushteve për një konkurrim të drejtë dhe të pa anshëm të operatorëve ekonomikë.

Me Ligjin e prokurimit publik përcaktohet qartë se vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit janë vendimet përfundimtare, kështu që në faqen 29 të Raportit është theksuar se ka pasur autoritete kontraktuese që nuk i kanë respektuar vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit. Mbetet për të bërë shumë në këtë drejtim në të ardhmen, që autoritetet kontraktuese të respektojnë vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit sepse mosrespektimi i vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit bëjnë që të ketë shkelje të Ligjit të prokurimit publik dhe ndikojnë negativisht në shfrytëzimin e fondeve publike.

Nga Raporti vërejmë se nga 430 ankesa të shqyrtuara, në 14 raste është iniciuar padi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Në asnjë padi të iniciuar Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka marrë kurrfarë informacioni nga kjo gjykatë se vendimet e kontestuara a janë vendosur në favor të palës ankimore apo të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Kjo është shqetësuese sepse gjykatat duhet të jenë më të efikase në shqyrtimin e rasteve, sepse vetëm me efikasitetin e punës së gjykatave do të kenë siguri në shfrytëzimin e drejtë të fondeve publike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe rekomandimin e Komisionit për buxhet e financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë dhe ju qytetarë të Kosovës,

Shteti i Kosovës përveç varfërisë, papunësisë së madhe, si rezultat i zhvillimit të ulët ekonomik, po vuan shumë, e para, nga administrata glomaze dhe institucionet e panumërta që kanë dalë qoftë si rezultat i Kushtetutës, ligjeve të dirigjuara nga ajo, pakos së Ahtisarit dhe direktivave që e përafrojnë vendin tonë me BE-në, institucione këto që ekzistojnë vetëm sa për të ekzistuar dhe është vështirë se mund të shihet puna e tyre dhe, dy, nga ligjet e panumërta të cilat nuk po implementohen.

Institucionet dhe organet, si Organi Shqyrtues i Prokurimit, është shumë mirë që ekzistojnë, por nuk mjafton për një shtet, si Kosova, që vetëm të kemi një institucion të tillë, sa për të thënë që e kemi. E ne themi se kjo është e pamjaftueshme në një vend ku perceptioni për korrupsionin është aq i lartë dhe është vetëm në rritje. Sipas Raportit të Transfer International, 73% e të anketuarve në Kosovë në vitin 2010 kanë pohuar se korrupsioni është në rritje, nga viti 2007 në vitin 2010, vetëm 8% e tyre mendojnë që korrupsioni është në ulje.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, neve na duhet puna e institucioneve e jo vetëm ekzistenca e tyre. Institucionet dhe organet e pavarura, si Organi Shqyrtues i Prokurimit, thuhet se janë të pavarura, por në fakt ato nuk janë të tilla. Ndikimi i Qeverisë në Kosovë është aq i madh, sa që është vështirë të gjenden institucionet e pavarura.

Organi Shqyrtues i Prokurimit para neve ka paraqitur një raport që mund të quhet raport, por askush nuk ka pritur që ky organ ta kritikojë vetveten, kështu që sot përpos raportit, ku ky organ i jep vetes nota dhe merita shumë të mëdha, ne duhet ta kritikojmë dhe shqyrtojmë punën e tyre. A mendojmë ne se ky organ po e kryen punën e paraparë me ligj? A kanë besim qytetarët në këtë organ? Çfarë na tregon numri i ankesave që bëhet në këtë organ dhe anën e kujt po e mbanë?

LDK ka shumë vërejtje në punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit në raportin e tij vjetor dhe ne mendojmë se ky organ e mbanë një pjesë të përgjegjësisë për të gjitha parregullsitë që po ndodhin në prokurimin publik, ku si rezultat Kosova po përballet me një shkallë shumë të lartë të perceptimit për korrupsionin.

Organi Shqyrtues i Prokurimit herë merr anën e autoriteteve kontraktuese, herë të Agjencionit të Prokurimit, herë të operatorëve ekonomikë, varësisht se kush i ofron më shumë.

Mjafton të përmendim skandalin e vitit të kaluar, kur Organi Shqyrtues i Prokurimit i del në ndihmë Z-mobail, duke e anuluar vendimin e Doganës, pasi që kjo e fundit merr vendim të anulojë tenderin me rastin kur kupton se kjo kompani po hetohet nga EULEX, gjithmonë duke u bazuar në Ligjin për prokurim publik, neni 59 pika a)1. pika 3. Merrni me mend, Organi Shqyrtues i Prokurimit shkel Ligin e prokurimit publik dhe çka, me çfarë arsytimi? Sigurisht përqindja qëndron prapa. Për këto dhe gjëra tjera, Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka raportuar fare. Kjo dhe rastet e tilla iu kanë mbyllur derën operatorëve ekonomikë, thjeshtë kompanitë nuk kanë ku të ankohen dhe çmimi i çdo tenderi tanimë në Kosovë dihet, ai është 10% por jo në të gjitha rastet, se kur konkurrenca është e madhe, ai çmim edhe mund të ngrihet e operatorët ekonomikë vetëm duhet ta dinë se kujt i japin 10%, sepse janë disa organe të cilat me rrotacion e marrin këtë 10%.

Organi Shqyrtues i Prokurimit na raporton se gjatë vitit 2010 ka pranuar 585 ankesa, çka do të thotë vetëm 4.3% në të gjitha kontratat e nënshkruara publike kanë parashtruar ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Është një shifër shumë e vogël në krahasim me 70% të popullsisë që kanë perceptim për korrupsionin e lartë në Kosovë. Kërkesa

apo ankesa, do të thotë, 430 prej tyre nga operatorët ekonomikë dhe 155 nga autoritetet kontraktuese.

Nëse flasim për 430 ankesa të bëra nga operatorët ekonomikë, në raport thuhet se janë shqyrtuar 331 prej tyre, ku Organi Shqyrtues i Prokurimit për 135 vendos në favor të autoriteteve kontraktuese, ndërsa për 84 raste Paneli shqyrtues vendos t'i dërgojë në rivlerësim dhe 62 raste ka vendosur t'i çojë në ritenderim. Në të dy rastet e fundit, që janë komplet 146 raste, bëhet fjalë për shkelje të rëndë të Ligjit të prokurimit publik.

Mirëpo, raporti nuk e thotë se çka ka ndodhur me këto raste, pasi që ato janë rivlerësuar, respektivisht janë ritenderuar. A mos vallë këto kanë ndodhur vetëm dhe vetëm për të justifikuar ekzistencën e këtij institucioni dhe pas rivlerësimit, respektivisht pas ritenderimit prapë operatorët e njëjtë kanë fituar tenderë. Duke qenë se jetojmë në Kosovë, e për deri sa të mos raportohet ndryshe, ne mendojmë se kështu ka ndodhur.

Ndërsa, çfarë ndikimi ka Qeveria dhe institucionet e tjera në këtë organ të pavarur, shihet nga shqyrtimi i ankesave nga autoritetet kontraktuese, ku prej 155 ankesave, 105 prej tyre aprovohen. 42 prej tyre kanë të bëjnë me revokimin e nenit 30/a të Ligjit të prokurimit, i cili është nen për moslejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Këtu bëhet fjalë, të nderuar, për tenderët njëburimor, që Organi Shqyrtues i Prokurimit iu lejon autoriteteve kontraktuese, e tenderët njëburimor në vitin 2010 nuk kanë qenë të paktë, kanë qenë komplet 186 milionë para të buxhetit të Kosovës. Ne mund ta marrim me mend se ka pasur mjaft ankesa nga operatorët ekonomikë ose ata nuk po ankohen, sepse nuk po kanë ku të ankohen.

Në Raport, në pjesën e buxhetit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nuk janë paraqitur askund të hyra që parashtruesit e ankesës paguajnë për çdo ankesë 500 euro sipas nenit 118 të Ligjit për prokurim publik.

Në Kosovë perceptioni për korrupsionin është shumë i madh dhe gjithmonë kur flitet për korrupsion, në 90% të rasteve aludohet në prokurim dhe ekskluzivisht në tendera.

Ne mendojmë se institucioni në fjalë nuk e ka kryer punën si duhet. Në Kosovë kemi një tendencë të mishërimit të institucioneve mbikëqyrëse dhe atyre që këto të fundit mbikëqyrin sa që qytetarët e kanë vështirë ta dallojnë njërin prej tjetrit.

Për këto dhe arsye tjera, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk do ta votojë raportin dhe ne këmbëngulin se puna e këtij institucioni duhet të përmirësohet. Qytetarët ndjehen se nuk kanë ku të ankohen dhe ankesën në këtë institucion e konsiderojnë si humbje kohe. Këtë institucion ata duhet ta konsiderojnë si vend dhe si instrument ku mund ta luftojnë korrupsionin e jo si vend ku bëhet korrupsion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar i AAK-së, me kartelë të Kymete Bajraktarit, deputeti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! I nderuar zoti kryesues,  
E nderuara zonja zëvendëskryeministre,  
Përshëndes edhe ministrat në kabinetin qeveritar, nëse janë,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Organi Shqyrtues i Prokurimit ushtron aktivitetin e vet mbështetur në Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin mbi partneritetin publiko-privat. OSHP-ja është e përkushtuar në mbrojtjen e operatorëve ekonomikë nga veprimet e paligjshme të autoriteteve kontraktuese në një procedurë prokurimi apo koncesioni. Pra, OSHP-ja shqyrton procedurat e prokurimit me qëllim që të ndriçohen faktet që kanë shkaktuar dhe që kanë paraqitur ankesa operatorët e ndryshëm ekonomikë me rastin e tenderëve të ndryshëm.

Gjatë vitit 2010 është paraqitur një numër i konsiderueshëm i ankesave, edhe pse ky numër është shumë i vogël se sa që përflitet se janë bërë shkelje të Ligjit të prokurimit publik, po gëzon fakti se vit për vit është duke u rritur numri i ankesave të operatorëve ekonomikë me qëllim të zbatimit të Ligjit të prokurimit.

Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, kërkesa e Grupit Parlamentar është që ky organ shqyrtues të jetë i pa anshëm, të jetë shumë më transparent, të jetë profesionalisht më i përgatitur me qëllim të rritjes së besimit tek operatorët ekonomikë.

Një kërkesë tjetër e Grupit Parlamentar është që angazhimi parësor i këtij organi për forcimin e marrëdhënieve me operatorët ekonomikë, që t'i informojë mbi shërbimet dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, duke mos lejuar favorizime dhe shkeljen e Ligjit në procedurat e prokurimit publik. Në këtë drejtim, rreth Ligjit të prokurimit publik ka vërejtje të shumta, ka edhe nga Komisioni Evropian, ka edhe raporte të ndryshme të cilat thonë që Ligji i prokurimit është duke mundësuar që të bëhen shkelje të shumta, prandaj kërkojnë që nga Organi shqyrtues po edhe nga deputetët dhe tjerët që të jetë një ligj më praktik, që në Kosovë të ndodhet një shkallë më e ulët e korrupsionit, prandaj me këto vërejtje Grupi i Aleancës e përkrah këtë raport, duke shpresuar që në të ardhmen mos të përsëriten këto gabime.

Dhe, për fund, do të thosha që këto raporte të cilat po shqyrtohen në Komisionin e Buxhetit, është mirë që të shqyrtohen pasi që të kryhet auditimi, të kryej punën e vet për arsye se shpeshherë po ndodh që në raportet e tilla të vihen të hyrat dhe të dalat të shkruara, ndërsa raporti i auditimit po qet se ka pasur shkelje. Prandaj, unë shpresoj që Komisioni i Buxhetit, në bashkëpunim me Komisionin e Kontrollit të Financave të bashkërendojnë dhe të bashkëveprojnë bashkërisht që në të ardhmen të raportohet nga këto dy komisione bashkërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Përshëndetje për të gjithë!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re ka shqyrtuar raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010. Duke marrë parasysh se Organi Shqyrtues i Prokurimit ushtron aktivitetin e vet në bazë të shumë ligjeve të cilat janë miratuar brenda këtij Kuvendi të Kosovës dhe duke marrë parasysh se funksionon edhe në bazë të legjislacionit dytësor, domethënë në bazë të rregulloreve të prokurimit, pjesa e vendimeve të cilat merren gjatë procesit të vlerësimit mund të them se Organi Shqyrtues i Prokurimit prapë se prapë mbetet në të ardhmen të jetë një institucion edhe më i pavarur, pavarësisht se ai bord është miratuar i këtij organi brenda këtij Kuvendi në mbrojtje të operatorëve ekonomikë dhe në mbrojtje të operatorëve të huajë ekonomikë. Parim parësor i OSHP-së është që në paanshmëri të mbrojë të gjithë operatorët, të jetë transparentë dhe në mënyrë profesionale mos të ketë diskriminim ndaj operatorëve të cilët konkurrojnë për një punë në të cilën mund të jenë ndoshta edhe të diskriminuar. OSHP-ja, në bashkëpunim me agjencionet e prokurimit publik dhe autoritetet kontraktuese, edhe një herë kërkohet edhe nga raportet e progresit evropian që të jetë më transparente dhe njëkohësisht numri i ankesave të cilat janë paraqitur në këtë raport, të jetë më i vogël në bazë të rekomandimeve të cilat vijnë prej organizatave të huaja ndërkombëtare dhe njëkohësisht të respektohen të gjitha ligjet në të cilat atakohet Organi Shqyrtues i Prokurimit, në mënyrë që sa më të denjë për të gjithë operatorët të ketë një mundësi më të mirë, që operatorët ekonomikë të zhvillojnë punën e tyre.

Duke marrë parasysh se ky raport është diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, edhe parafolësi e potencoi edhe çështjen e auditimit, atëherë mund të them se Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re në parim duhet ndoshta edhe ta mbështet këtë raport që të ecë, por njëkohësisht rekomandon që Organi Shqyrtues i Prokurimit, së bashku me Bordin e tij të marrë parasysh rekomandimet të cilat vijnë edhe nga Raporti i progresit dhe njëkohësisht të jetë edhe më transparent, më i hapur dhe njëkohësisht të zbatojë ligjet në të cilat atakohet drejtpërdrejt në mënyrë sa më të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, Rashiq, a keni...? Nuk ka! ”6+”, nuk ka!

Deputetë të paraqitur të tjerë për diskutim nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e raportit. Sa është numri i deputetëve prezentë në sallë? Në sallë janë 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Atëherë, konstatoj se me shumicë votash, 39 “për”, 20 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

## **8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2010**

Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2010 e ka shqyrtuar komisioni funksional dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryesues!

Në bazë të nenit 87, paragrafi 2, pikë 9 të Ligjit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik përgatit dhe dorëzon në Kuvendin e Republikës së Kosovës për çdo vit një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Agjencia e Prokurimit Publik kanë dorëzuar raportet e tyre brenda afatit të paraparë me ligj, por në mënyrë të veçantë dhe jo sikur kërkohet me nenin 87, paragrafi 2, pikë 9, që të dorëzohet një raport i përbashkët me Agjencinë e Prokurimit Publik.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më datën 6 prill 2011, shqyrtoi Raportin vjetor për vitin 2010 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Raportin vjetor për vitin 2010 të Agjencisë së Prokurimit Publik, si aneks të raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe vlerësoi se i njëjti i përmbush kushtet ligjore të parapara me nenin 87 dhe 88 të Ligjit Numër 03/L-241 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, ku janë grumbulluar, analizuar dhe publikuar aktivitetet e prokurimit publik që kanë ndodhur gjatë vitit 2010.

Janë paraqitur kontratat publike të dërguara nga auroitetet kontraktuese, janë bërë monitorimet dhe interpretimet ligjore të Ligjit të prokurimit publik për nevojat e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë për të rritur vetëdijen e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë mbi legjislacionin e prokurimit publik, si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e përcaktuara në këtë legjislacion, ashtu siç e parasheh ligji.

Është evidentuar në raport edhe bashkëpunimi me IKAP-in në procesin e trajnimit të zyrtarëve të prokurimit. Po ashtu, janë ofruar informacione për mirëmbajtjen e faqes informative në internet, që i ofron publikut qasje të pakufizuar. Sipas ligjit, janë të paraqitura edhe rekomandimet se si të përmirësohet sistemi i prokurimit publik.

Ndërkaq, sugjerimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë qenë në përmirësimin e aktivitetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe prezantimi i tyre në raportin e ardhshëm. Këto sugjerime ishin shtimi i monitorimeve, bashkëpunimi më i ngushtë me Agjencionin e Prokurimit Publik dhe specifikimi i rekomandimeve për mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të legjislacionit në funksion të përmirësimit dhe të avancimit të sistemit të prokurimit publik.

Komisioni me këto sugjerime i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2010. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar zëvendëskryeministre,

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Duke u bazuar në Ligjin 03/L-241 të nenit 87, ky Komision Rregullativ i Prokurimit Publik obligohet t'i raportojë Kuvendit për çdo vit kalendarik. Ky Komision Rregullativ ka respektuar Ligjin në fjalë dhe në afatin kohor të paraparë ka dorëzuar Raportin vjetor për vitin 2010 në Komisionin për Buxhet dhe Financa, i cili e ka shqyrtuar dhe e ka rekomanduar në Kuvend për miratim.

Si grup parlamentar mendojmë se KRPP-ja në këtë raport ka dhënë një pasqyrë të qartë për të gjitha aktivitetet e prokurimit publik që janë zhvilluar në Kosovë gjatë vitit 2010. Sipas burimeve të financimit, ka dhënë sqarimet për të gjitha kontratat të cilat janë nënshkruar sipas burimeve të financimit, vlerës së kontratave, procedurave të prokurimit, operatorëve ekonomikë dhe afateve kohore.

Një rëndësi të veçantë raporti në fjalë ka edhe për donatorët që dëshirojnë të investojnë në Kosovë, sepse pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 85.47%, si procedurë më transparente e prokurimit publik.

Dhe, në fund, si grup parlamentar mbështesim edhe rekomandimet e KRPP-së për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" nuk është paraqitur askush. Po, në emër të LDK-së, deputeti Ali Sadriu. Paraqituni me kohë, ju lutem!

ALI SADRIU: Përshëndetje, të gjithë të pranishmëve!

Raporti i hartuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, i titulluar si raport mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2010, edhe nga vetë titulli, por edhe nga përmbajtja e tij më shumë është një raport statistikor. Duke u nisur nga fakti se njëri nga kompetencat kyçe të këtij komisioni, pra të Komisionit të Rregullativit të Prokurimit Publik është monitorimi dhe zbatimi i proceseve të prokurimit dhe duke iu referuar Raportit në fjalë, ku potencohet se Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim i KRPP-ës gjatë vitit 2010, prej 63 monitorimeve të planifikuara ka realizuar 35 monitorime, apo shprehur në përqindje është 56% të rasteve të planifikuara..., na jep të kuptojmë se ky institucion është larg përmbushjes së objektivave të planifikuara nga vetë institucioni në fjalë.

Gjithashtu, shtrohet pyetja se nëse kemi 161 autoritete kontraktuese në Kosovë dhe me këtë ritëm të institucionit përgjegjës për monitorim dhe mbikëqyrje të autoriteteve kontraktuese për proceset e prokurimit kur do të arrihet një monitorim kualitativ, kuantitativ dhe gjithëpërfshirës për të gjitha njësitë buxhetore.

Duke iu referuar raportit në fjalë, faqe 34, ku është bërë prezantimi i lëndëve të monitoruara gjatë vitit 2010, me ç'rast është cekur se janë monitoruar gjithsej 186 lëndë apo aktivitete të prokurimit, si dhe është cekur se cilat nene të Ligjit mbi prokurimin publik nuk janë respektuar nga autoritetet kontraktuese të monitoruara, të shprehura edhe në përqindje, është shqetësuese fakti se pjesëmarrje më të madhe në këtë përqindje me 47.85% ka mosrespektimi i nenit 57 që ka të bëjë me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, çka nënkupton se ka pasur vlerësime joreale apo edhe favorizuese, duke vazhduar më tutje në mosrespektimin edhe të neneve tjera të Ligjit të prokurimit të prezantuar në raport, të cilin e kemi në shqyrtim dhe sigurisht shkeljet të cilat janë konstatuar nga Departamenti i monitorimit pranë KRPP-ës, aq sa është shqetësues fakti i numrit të shkeljeve, llojit të tyre, të cilat me siguri se shpien drejt aferave korruptive të konstatuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, edhe më shqetësues është fakti se duke u bazuar në raportin në fjalë askund nuk figuron marrja e ndonjë mase eventuale ndaj shkelësve të ligjit, apo shtrohet pyetja për menaxhmentin e KRPP-së se mos ka ndonjë rast të shkeljeve serioze të konstatuar nga vetë institucioni në fjalë, me ç'rast edhe mosprocedimin e mëtutjeshëm në organet kompetente, siç janë Agjencioni Kundërkorrupsion apo hetimi. Në raport nuk figuron asnjë rast. Nëse ka pasur raste të tilla, është dashur të shënohen. Nëse nuk ka pasur, po ashtu është dashur të thuhet. Përderisa nuk figuron, ne konstatojmë se këto procese gjithsesi është dashur të procedohen tek institucionet gjegjëse.

Më tej, për të përforcuar bindjen se me të vërtetë është një institucion i cili vetëm konstaton dhe çdo konstatim e shndërron vetëm si të dhënë statistikore, po e marrim si shembull Raportin në fjalë, faqe 5, ku ceket, citoj: “nga gjithsej 161 autoritete kontraktuese, sa kanë ekzistuar në Kosovë në fund të vitit 2010, 158 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet, 3 autoritete nuk i kanë dorëzuar”. Bëhet fjalë për 3 komunat e veriut – Zubin Potokut, Zveçan dhe Leposaviq.

Me gjithë justifikimet që i prezanton KRPP-ja, mendojmë se nuk ka arsye sepse këtu nuk i është dashur ndihmë, as polic e as ushtar, sepse buxheti është këtu dhe thesari po ashtu është këtu dhe këto komuna domosdoshmërisht është dashur t'i detyrojnë që edhe ato të dërgojnë proceset e aktivitetit të prokurimeve të tyre.

Gjithashtu, në fund të raportit, faqe 36, jep rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Po e marrim si shembull njërin prej rekomandimeve, ku thuhet: “të zvogëlohet sa është e mundur përdorimi i kontratave me vlerë të vogël dhe minimale, duke shfrytëzuar marrëveshjet publike kornizë, si dhe prokurimin e centralizuar”.

Po pajtohem se është një rekomandim i duhur, por çdo rekomandim konsiderojmë se duhet të ketë edhe shpjegime se çka ka ngecur në sistemin e prokurimit, apo edhe kush është përgjegjës që ka ardhur deri te ky rekomandim, pra kush ka qenë dashur, cili institucion për shembull nuk e ka shfrytëzuar dhe mendojmë se edhe këtu mekanizmat e veprimtari janë të krijuar sepse pranë Qeverisë ekziston Agjencioni i Prokurimit Publik, si institucion i cili i përgjigjet Qeverisë dhe i raporton Qeverisë. Pra konsiderojmë se ka qenë dashur që krahas rekomandimeve për përmirësim të sistemit të prokurimit, të

saktësojë edhe përgjegjësinë dhe arsyet për mosfunksionimin e sistemit të prokurimit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeminstren dhe ministrin që është këtu!

Duke marrë parasysh se ne pak më parë e patëm raportin e OSHP-së, ndërsa tash shqyrtohet Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit, prapë do të potencoj edhe një herë se ne kemi pasur pengesa me Ligjin e prokurimit publik dhe dihet se vjet është riamendamentuar një pjesë e madhe e këtij ligji dhe duke u bazuar në Ligjin për prokurimin publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të funksionojë shumë strikt në bazë të këtij ligji. Në këtë raport janë paraqitur të dhënat e kontratave të cilat janë dhënë edhe për autoritetin kontraktues, siç janë Qeveria, në këtë rast ministritë, kompanitë publike dhe tjerë. Mund të them se në përgjithësi Raporti ka mundësi që herën tjetër Bordi i KRPP-së dhe i gjithë stafi i tyre që të punojnë pak në mënyrën më të duhur dhe të zbatohet ligji që të mos ketë pengesa tjera dhe numri i autoriteteve kontraktuese këtu të zbatohet pikë për pikë dhe kur të vjen një raport për vitin 2011, atëherë të kemi mundësi që të lavdërohet raporti i KRPP-së, mirëpo prapë se prapë në përgjithësi duke marrë parasysh se këto raporte është dashur të miratohet shumë më herët, por për arsye tjera politike janë vonuar, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re në parim e përkrah këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit, për vitin 2010.

Në mbledhje janë prezentë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatoj se me shumicë votash miratohet Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, janë 34 vota “për”, 23 “kundër” dhe 4 “abstenime”. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

### **9. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Kosovës për Trashigimi Kulturore për periudhën mars 2009 – dhjetor 2010**

Raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 – dhjetor 2010 e kanë shqyrtuar komisioni funksional dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim, me vërejtjet e paraqitura nga komisioni funksional.

Sipas radhës së diskutueseve, kryetari i komisionit funksional, Idriz Vehapi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ EHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2011, shqyrtoi Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 – dhjetor 2010 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë vlerësim dhe rekomandim.

Raporti i punës i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010, miratohet me këto vërejtje të Komisionit:

Komisioni konstaton se në këtë raport vërehet mungesa e bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Komisioni ka vërejtje në funksionimin e Këshillit, duke pasur parasysh përbërjen jo të plotë të tij. Gjithashtu, Komisioni ka vërejtje në nxjerrjen dhe miratimin e akteve të brendshme duke pasur parasysh mos përbërjen e plotë të Këshillit.

### **Arsyetim**

Në bazë të nenit 4, pika 8 të Ligjit për trashëgiminë kulturore të Kosovës, Ligji nr. 02-L-88, Kuvendi i Kosovës themelon Këshillin e Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, si autoritet për vlerësimin e trashëgimisë kulturore.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2011, shqyrtoi Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010 dhe i rekomandon Kuvendit të njëjtin për miratim me vërejtjet e parashtruara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sali Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 - dhjetor 2010 dhe ka paraqitur disa vërejtje lidhur me këtë raport. Këshilli për Trashëgimi Kulturore është formuar më 2 nëntor të vitit 2007, në mandat trevjeçar, i përberë prej 7 anëtarësh. Këshilli për Trashëgimi Kulturore ka filluar funksionimin e tij në shkurt të vitit 2009 dhe po ashtu ka filluar në përpilimin e Rregullores së brendshme për këtë këshill. Ky këshill nuk ka qenë i kompletuar në funksionalizimin e tij, sipas vendimit të Kosovës, për shkak se që në fillim dy anëtarë të këtij Këshilli nuk kanë marrë pjesë fare dhe po ashtu dy anëtarë të tjerë nuk kanë marrë pjesë në përpilimin e Rregullores së brendshme të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, gjë që do të thotë se këtë Rregullore e kanë përgatitur vetëm 3 anëtarë.

Në nenin 10 të Rregullores për Trashëgimi Kulturore thotë se pjesëmarrja më së paku të 5 anëtarëve e përbëjnë kuorumin, vendimi është i plotfuqishëm, nëse një çështje përkrahet nga shumica e anëtarëve të pranishëm dhe kjo nuk ka ndodhur për shkak se nuk ka pasur kuorum edhe në marrjen e vendimeve tjera të cilat ka zhvilluar ose ka marrë Këshilli për Trashëgimi Kulturore.

Me datën 25.11.2009, është mbajtur një takim në mes Ministrisë për Kulturë dhe po ashtu Komisionit Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ku kanë dalë 5 rekomandime lidhur me disa kërkesa që ka pasur Këshilli për Trashëgimi Kulturore.

Nën një, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore.

Nën dy, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është organ këshillëdhënës dhe profesional, i cili ka për objekt të veprimtarisë fushën e Trashëgimisë Kulturore.

Nën tre, për ushtrimin e veprimtarisë së tij, Këshilli mund të formojë Komision ad-hoc dhe të bashkëpunojë me institucionet kompetente për trashëgiminë kulturore.

Nën katër, Komisioni konsideron se për funksionimin e veprimtarisë së tij Këshilli duhet të ketë staf teknik dhe jo staf profesional, dhe

Nën pesë, kërkesa e Këshillit për staf profesional, që kërkohet në bazë të konkursit publik, konsiderohet se është i pabazë nga se vetë Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore përbëhet nga ekspertë profesionalë të trashëgimisë dhe këtu i është dhënë mundësia që t'i lejohet vetëm për staf teknik. Trashëgimia kulturore që 10 vite ka qenë politike dhe vazhdon ende të jetë politike. Siç e thamë në fillim, Këshilli për Trashëgimi Kulturore është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, më 2 nëntor të vitit 2007, dhe mandati i këtij Këshilli ka përfunduar me 2 nëntor të vitit 2010 dhe kjo do të thotë që ky Këshill që 6 muaj është jolegjitim.

Lidhja Demokratike e Kosovës, në programin e saj ka në prioritet trashëgiminë kulturore dhe mbështet Këshillin për Trashëgimin Kulturore, i dalë nga Ligji për trashëgimin kulturore dhe njëkohësisht kërkon nga kryetari i Kuvendit, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të emërojë anëtarë të Këshillit të ri për Trashëgimi Kulturore, sepse si i tillë ai është i mangët dhe është në kundërshtim me ligjin i cili është në fuqi. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Liburn Aliu.

**LIBURN ALIU:** Të nderuar deputetë,

Deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” do të votojnë Raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për periudhën mars 2009 deri në dhjetor të vitit 2010. Do ta votojmë edhe përkundër vërejtjeve që do të parashtroj në vazhdim. E vlerësojmë punën e bërë, edhe pse konsiderojmë se do të duhej të bëhej më tepër, si dhe

radhitja e prioriteteve për këtë Këshill do të duhej të jetë në përputhje me nevojat dhe problemet konkrete që ballafaqohet sot trashëgimia kulturore e Kosovës si pasojë e indiferencës dhe pandjeshmërisë së institucioneve në lidhje me trashëgiminë kulturore, si një ndër elementet kryesore të zhvillimit kulturor.

Në raport shohim një listë të aktiviteteve që ka bërë ky këshill. Kjo listë e aktiviteteve që përbehet nga problemet që i ka në Ministrinë dhe nga pjesëmarrja në konferenca të ndryshme, vizita nëpër vende të ndryshme, e që dominohet nga këto të fundit, nuk do të duhej të ishte kështu e tillë. Ne kemi nevojë që të prezantojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës nëpër konferenca dhe seminare, pasi në opinionin botëror kudo, trashëgimia kulturore është trajtuar nga prizmi i kompromiseve të bëra në negociatat e Vjenës.

Ky prezantim do të duhej së pari të paraprihej nga një trajtim serioz i trashëgimisë kulturore ortodokse mesjetare në Kosovë, e cila gabimisht dhe me dashakeqësi quhet serbe. Jam i bindur që ekspertët në këtë këshill e kanë të qartë pasojën e trajtimit të gabuar të trashëgimisë që bën Kushtetuta e Kosovës dhe pakoja e Ahtisarit, pasojë kjo që synon të rezultojë me deformimin e historisë dhe shqiptarëve në Kosovë. Prandaj, ky këshill do të duhej, nga ky këshill do të duhej të prisnim një trajtim profesional të trashëgimisë mesjetare ortodokse, duke e liruar atë nga etiketimet qëllim këqija e jo largim thjeshtë nga trajtimi i trashëgimisë kulturore ortodokse, duke e konsideruar si fakt të kryer në negociata dhe për të cilin më nuk kemi çfarë të bëjmë.

Studimi dhe trajtimi shkencor i trashëgimisë nuk njihet negociata dhe nuk njihet kompromise, pasi ky këshill do të duhej të argumentonte të kundërtën e marrëzive të bëra në Vjenë, ta lirojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës nga kthetrat e shovinizmit dhe kompromiset e bëra në Vjenë. Do të duhej shumë që në raport atë shihnim aktivitete që sensibilizojnë dhe vënë në trajtim çështjen e artefakteve të Kosovës të vjedhura nga pushteti serb. Sot ato nuk trajtohen fare askund. Do të duhej së paku të shihnim një letër të drejtuar Komisionit Ndërkombëtar të Muzeumeve në lidhje me këto artefakte që janë pasuri e Kosovës. Do të duhej të bëhej presion mbi Qeverinë dhe kudo në lidhje me këtë problem.

Çështje tjetër që do të duhej të shihnim në këtë raport, është reagimi në lidhje me shkatërrimin e qytetit antik, të zbuluar me rastin punimeve në autostradë. Në fshatin Vlashnje, afër Prizrenit, u zbulua vendbanim antik, i cili me arrogancën më të madhe u shkatërrua dhe u mbulua nga punuesit e autostradës. Kjo punë heshtet. Natyrisht që për këtë problem hesht Qeveria, pasi është pjesë e saj dhe nuk ka fare ndjeshmëri për vlera të trashëgimisë kulturore, por kjo çështje duhet trajtuar me urgjencë nga këshill, gjë që shpresoj ta kenë bërë apo ta bëjnë së shpejti dhe reagimi i tyre të mos kufizohet vetëm me shkresën zyrtare që i adresohet Qeverisë, e në përgjithësi ka të bëjë me monitorimin e punimeve të autostradës në lidhje me trashëgiminë.

Tek pjesa e raportit ku flitet për bashkëpunimin me institucionet, do të donim dhe do të duhej të shihej patjetër qëndrimi dhe raporti me të ashtuquajturin RIK, që nga gjuha angleze i bie Komisioni për Implementim të Rindërtimeve, e që nuk është gjë tjetër

përpos trup i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kishës Ortodokse Serbe në Beograd dhe Institutit të Beogradit për mbrojtjen e monumenteve. Ky trup, i krijuar para shpalljes së pavarësisë, sot është ende gjallë dhe funksionon në projektin e Qeverisë, që njihet si PCDDK, e që nga gjuha angleze i bie të quhet Promovimi i Deversitetit Kulturor në Kosovë, ku njëra nga komponentët e këtij projekti është pikërisht RIK-u. Përdorisa për komponentë tjerë të këtij projektim mund të gjejmë informacion, e që kanë të bëjnë me edukimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe zhvillimin lokal, kur bëhet fjalë për RIK-un, nuk mund të gjejmë asgjë. Kjo gjë duhet mbajtur natyrisht e fshehtë. Serbia edhe këtu i ka zgjatur ekstremitetet e saj në këtë projekt të Qeverisë, si kudo e gjithë andej nëpër Kosovë dhe kjo duhet luftuar dhe këtë do të duhej ta bënte këshilli, pasi ata janë ekspertë të pavarur, se sa për Qeverinë, ne e dimë se ajo nuk e ka problem këtë depërtim, gjë që po dëshmon çdo ditë nëpër negociatat e kompromiset që po i bën. Këshilli do të duhej të mos pres nga Ministria, pasi në raport thuhet se nuk janë dorëzuar listat nga Ministria, listat që kanë të bëjnë me monumentet tjera të mbrojtura, por Këshilli duhet patjetër ta bëjë punën e tij dhe të mos pret nga Ministria, sepse po priti vazhdimisht, atëherë do të bie në nivelin që nuk i përket me kompetencat që ai i ka.

Do të duhej që lista e monumenteve të mbrojtura të shtohet vazhdimisht dhe të kompletohet, pasi monumente të mbrojtura të shpallura nuk kemi më që nga periudha e pasluftës. Po ashtu, do të duhej që këshilli të kompletohet dhe të funksiononte si i kompletuar, sepse tanimë nuk është i tillë. Do të duhej të punojë dhe të mos pres nga Qeveria në lidhje me inventarizimin, që e thashë, si dhe do të duhej të bëjë presion të vazhdueshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pasi në mungesë të këtij presioni do të vazhdojë që buxheti i ndarë për projektet e trashëgimisë, të përfundojë në lëmi të tjera, siç pati ndodhur që buxheti i ndarë për turizmin rural të shpenzohet për sivilata të modës.

Shpresojmë që në të ardhmen ky këshill ta bëjmë punën e tij tamam ashtu si duhet dhe të kemi rezultate. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Time Kadrija.

TIME KADRIJAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Si në çdo periudhë, si në çdo pjesë të rruzullit tokësor, edhe në territorin e Kosovës së sotme, duke filluar nga periudhat parahistorike, vazhdon kontinuiteti i jetës njerëzore, ndërsa formacionet etno-kulturore kanë lënë si trashëgimi shumë të mëdha mbi rëndësinë dhe vlerat kulturore.

Kosova paraqet një thesar të pasur të trashëgimisë kulturore, materiale e shpirtërore të periudhave të ndryshme historike të cilat, pos tjerash, me karakteristikat dhe veçoritë e tyre dallohen nga shumëllojshmëria e cilësive, e vlerave dhe rëndësisë së tyre historike. Vlerat e kësaj trashëgimie janë universale dhe ato nuk mund të futen në regjimet aktuale të qarjeve dhe plasaritjeve politike, etnike dhe fetare. Megjithatë, është për të ardhur keq që gjërat nuk qëndrojnë kështu. Problemi i mbrojtjes së trashëgimisë, i bërë

nga një barbarizëm i përgjithshëm i raporteve që është fuqizuar në tri dekadat e fundit. Ky barbarizëm i raporteve në trajtën e përçmimit dhe mohimit të vlerat e tjetrit e ka instrumentalizuar edhe trashëgiminë kulturore dhe fetare për nevojat e qëllimeve dhe fushatave aktuale politike, kombëtare dhe fetare dhe pikërisht monumentet më me vlerë janë instrumentalizuar më së shumti dhe si pasojë janë kërcuar nga barbarizmi, çka nënkupton edhe rrezikun për dëmtimin e madje edhe për zhdukjen e tyre.

Për të kuptuar sa më konkretisht problemin, do të marr shembullin e monumenteve më me vlerë që ka Kosova. Manastirin e Deçanit, UNESCO e ka futur në listën e trashëgimisë botërore, Patrikanën e Pejës dhe Manastirin e Graçanicës. Në Kosovë ka edhe trashëgimi kulturore të kategorisë më të lartë, por këtu po kufizohem me këto tri monumente. Nuk ka dyshim se këto tri objekte të kultit, por edhe të arteve janë një thesar me vlera universale dhe i takojnë njerëzimit....

KRYESUESI: Përkthim nuk ka, më falni, regjia, nuk ka përkthim serbisht.

... dhe jo ekskluzivisht të ndonjë kulture, kombi ose religjioni të veçantë, pa marrë parasysh kush i shfrytëzon ato për nevojat e kultit. Kuptohet, vlera e tyre universale nuk kundërshton faktin se ato janë ndërtuar në kushtet dhe rrethana specifike, kulturore dhe historike dhe se bëjnë pjesë në kulturën e krishterë-ortodokse. Mirëpo, në kontekstin e tensioneve të larta kombëtare dhe fetare në ish-Jugosllavi, qarqet nacionaliste serbe kanë bërë gjatë viteve '80 një reduktim radikal të qasjes ndaj kësaj trashëgimie kulturore, duke e nacionalizuar dhe politizuar në tërësi. Ndërkaq, historiografia objektive dëshmon të kundërtën, se nuk mund të pohohet kurrëse se këto monumente kanë qenë serbe në kuptimin etnik të fjalës.

Në luftën e fundit në Kosovë kanë pësuar edhe shumë objekte të kulturës, siç është rasti në Kompleksin e Çarshisë në Gjakovë, Vushtri, Pejë e tjerë. Po ashtu janë djegur edhe shkatërruar objekte të kultit, xhamia dhe kisha dhe shumë shtëpi muze, ndërkaq tash së fundit disa objekte që i kishin shpëtuar luftës, po rrënohen dhe mbi themelet e tyre po ndërtohen ndërtesa të reja.

Trashëgimia kulturore e Pejës me rrethinë gjatë periudhave kohore ka përjetuar ngritje dhe rënie të tëra, është varur nga regjimi. Periudha e vështirë e luftës në Kosovë i solli dëmtime të natyrave të ndryshme që ndikuan shumë në të gjitha anët e zhvillimit jetësor të saj. Regjioni i Dukagjinit gjer në vitin '99 ka pasur në mbrojtje 83 monumente, aktualisht ky regjion numëron 960 monumente kulturo-historike të evidentuara. Regjioni i Pejës është regjioni i dytë në Kosovë për nga numri i monumenteve dhe trashëgimisë kulturo-historike. Për Kosovën e pavarur mbrojtja e trashëgimisë kulturore do të jetë test i rëndësishëm i nivelit të civilizimit. Është e domosdoshme ngritja e vetëdijes për vlerën, por dhe interesin e Kosovës që kjo trashëgimi të mbetet e pacenuar nga politikat dhe pasionet nacionaliste.

Në Kosovë duhet të punohet më shumë për çrrënjosjen e paragjykimeve për manastiret ortodokse dhe në përgjithësi për monumentet historike, fetare dhe kulturore. Këto monumente, sa janë serbe, edhe më shumë janë kosovare dhe i takojnë trashëgimisë së

njerëzimit. Jo pak herë kemi dëgjuar se Kosova, nëpërmjet trashëgimisë së saj lirisht mund të quhet thesari i Ballkanit. Jo rrallë herë nëpër debate, konferenca, mitingje të ndryshme dëgjojmë se Kosova është e lashtë dhe tokë Dardane. Por shtohet pyetja se çfarë po bëjmë ne që kjo trashëgimi kulturore, pa marrë parasysh se a është fetare apo jo, e që nuk bën assesi të ndahet mbi këto baza, të rimëkëmbet pasi që një numër i madh i këtyre monumenteve kulturore fetare, me vlera të rralla jo vetëm për Kosovën, por edhe për Evropën, tashmë veç janë në shkatërrim e sipër.

Nga e gjithë kjo fatkeqësi që ka kapluar këto monumente, shtrohet pyetja se për çfarë na duhen? Se trashëgimia kulturore e Kosovës po përjeton ditët më të zymta të saj, është vërtetuar muaj më parë në Prishtinë, ku është mbajtur një tryezë me temë: Ligji i trashëgimisë kulturore në Kosovë, nga ku kanë dal konkluzionet se Ligji për trashëgiminë kulturore duhet të plotësohet me disa akte nënligjore, sepse ky ligj i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës nuk zbatohet në praktikë fare në terren. Në botë nga trashëgimia kulturore, shtetet që dinë ta vlerësojnë atë, përfitojnë mjaft pasi tërheqë shumë turistë dhe promovojnë kulturën dhe shkallën e civilizimit të tyre.

Objekt i veprimtarisë së Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore është ruajtja, vlerësimi dhe trajtimi i të gjitha llojeve të trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Kosovës. Veprimtarinë e zhvillon nëpërmes identifikimit, dokumentimit, studimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe cilësimit në mbrojtje të përhershme, konservimit, restaurimit prezantimit, interpretimit dhe integritetit të saj në jetën bashkëkohore.

Sipas raportit, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i Këshillit me instancat që duhet të bashkëpunojnë sipas ligjeve në fuqi, nuk kanë funksionuar. Sipas raportit, ende nuk është formuluar lista e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës. Arse prapë mosbashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe për zonat e veçanta, mosbashkëpunimi me ICO. Përshkrimet e detyrave në Kushtetutë, ligje e Rregullore e që përsëriten, nuk janë të mjaftueshme për ta kryer punën. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës ndanë 2.596.876 euro për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndërsa për veturat e veta ndanë 1.5 milionë euro. Sa për përkujtim, Presidenca rishtazi ka blerë 10.000 euro telefona mobil. Krahasoni të dhënat dhe nxirrni konkludimin vetë.

Shpenzimet e prezantuara në raport, kryesisht janë shpenzime në paga, mëditje, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e telefonave, dreka e derivate, le të supozojmë se gjitha këto janë në rregull, por cili është efekti i ekzistimit të këtij këshilli. Ky Këshill ka qenë dashur të na lajmërojë për gjendjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe të shndërrohet në një institucion i cili kërkon gjithmonë më shumë nga Qeveria e jo institucion që funksion për hir të vetvetes.

Aleanca mendon se Qeveria e Kosovës nuk po bën as minimumin e duhur për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulture, e sa për avancim, as që bëhet fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, deputeti Amir Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi ynë Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re konstaton se Këshilli për Trashëgiminë Kulturore nuk paraqet para deputetëve një pasqyrë të vlerësimit të trashëgimisë kulturore të vendit tonë, se si ka qenë gjendja kur është themeluar ky këshill dhe si është duke u përmirësuar, nëse është duke u përmirësuar gjendja e trashëgimisë kulturore, në mënyrë tabelore të jetë kjo dhe përfundimisht se si duket trashëgimia në kohën në të cilën po raportohet.

Nën dy, përveç konstatimeve të Komisionit për Arsim dhe Kulturë, që i përmendi edhe zoti Vehapi, se ky këshill ka vërejtje në funksionimin, ky raport nuk lë përshtypjen se ka një strategji të qartë për punën e vet, e mungesa e një strategjie të qartë, si do të bindë deputetët e Kuvendit të Kosovës për të përkrahur financimin e këtij këshilli, edhe pse kemi nevojë shumë të madhe për një këshill të tillë.

Nën tre, mos të harrojmë se një pjesë jo e pakët e trashëgimisë kulturore të vendit tonë, janë edhe trashëgimia fetare, kur kemi parasysh se gjatë luftës së fundit në vendin tonë janë shkatërruar 218 xhami dhe ky këshill nuk ka bërë as mundin më të vogël për të ndihmuar meremetimin e tyre ose për të gjetur donatorë për meremetimin e tyre. Me këtë rast, bashkëpunimi i Këshillit për Trashëgimi Kulturore me Kishën ortodokse dhe mosbashkëpunimi i Këshillit për Trashëgimi Kulturore me Bashkësinë Islame të Kosovës, është evident dhe i paarsyeshëm për udhëheqësit e këtij Këshilli.

Për t'u njohur me gjendjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë, mjafton të shikohet gjendja në teren, sepse raporti flet shumë pak, por duke pasur parasysh nevojën për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore në vendin tonë dhe duke dëshiruar që ta fuqizojmë këtë këshill, Koalicioni për Kosovë të Re në parim e miraton raportin, por kërkojmë nga Komisioni për Arsim dhe Kulturë që shqetësimet tona t'i përcjell te ky këshill dhe ato shqetësime të gjejnë vend në raportin e ardhshëm nga Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! SLS, a ka dikush të paraqitur? Jo. Nuk ka. Grupi Parlamentar "6+", nuk e ka kërkuar askush fjalën. Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër Hamza,

Të nderuar deputetë,

Trashëgimia e pastër kulturore e Kosovës duhet të ... në mënyrë më të përgjegjshme, vërehet edhe nga prezantimi në raportin e tyre, prezantimi i vlerave të larta kulturore të popullit tonë do të duhej të ishin synim i këtij këshilli në kohën kur ka tendenca të demonizimit të vlerave kombëtare e kulturore të Kosovës si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë. Me gjithë vërejtjet që u thanë dhe jo bashkëpunimit të mirë me Ministrinë

gjegjëse dhe duke pasur parasysh edhe skadimin e mandatit të këtij këshilli, të cilin e thanë edhe kolegët paraprakë, propozoj që të fillohet me procedura më të shpejta për zgjidhjen e anëtarëve të rinj të këtij këshilli.

Këtë raport e mbështes, me shpresë se së shpejti do të zgjedhim anëtarët e ri të këtij këshilli, të cilët do të punojnë më me zell dhe do të jenë më bashkëpunues me Ministrinë gjegjëse dhe do t'i kushtojnë vëmendje edhe trashëgimisë së re kulturore të historisë më të re të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Desha të jap pak kontribut në këtë çështje. Është shumë e rëndësishme që të këmbëngulet që Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë t'i mundësohet, por edhe Ministrisë së Kulturës mbulimi i territorit të Kosovës apo më konkretisht hartës së trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Komisioni për rindërtimin që u përmend këtu, që ka filluar nga një memorandum i Ministrisë së Kulturës, Kishës ortodokse serbe dhe UNMIK-ut, është i një kohe tjetër që ndoshta në kohën kur është bërë mund të arsyetohet për obligimet që ka marrë Kosova në tejkalim të ngjarjeve të vitit 2004, megjithatë në Kosovën e pavarur shtrohet pyetja çfarë kërkon ky komision, kur koha ka kaluar që ai komision t'i kryej punët e veta.

Është insistuar edhe më herët, edhe tani që dosja complete e rindërtimit t'i jepet Ministrisë së Kulturës, ajo nuk është bërë deri tani. Prandaj, do të kishim kërkuar me të madhe që edhe ky këshill, edhe Ministria e Kulturës të posedojë dosjen complete të rindërtimit, ngase ata nuk kanë qasje në fakt se çfarë bëhet, aq më tepër kjo shqetëson për arsye se në atë komision Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Beogradit e përfaqëson një grua e cila është drejtore e Institutit, por është përpiluese e monografisë serbe ku përvetësohet trashëgimia kulturore e Kosovës. Ju e dini, vitin e kaluar është biseduar me të madhe rreth kësaj monografie dhe asistencë e Këshillit të Evropës në këtë drejtim, që po ashtu është mjaftë shqetësuese, është një zonjë tjetër e cila po ashtu është përpiluese dhe bashkautore e Enciklopedisë maqedone, ku përvetësohet kultura shqiptare.

Unë mendoj, këto janë elemente të cilat do të kërkonin që edhe Ministrinë, edhe Këshillin t'i fuqizojmë si Parlament i Kosovës që të mbrohet rrezikshmëria e trashëgimisë kulturore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër Hamza,

Më vjen keq që nuk është ministri i Kulturës. Është dashur të jetë këtu, të dëgjojë qëndrimin e Parlamentit, por edhe kryetarja e Këshillit për Trashëgimi, në pjesën e vet,

sepse është pjesë dhe është organ kushtetues i Kuvendit, më falni organ sipas Ligjit i Kuvendit, organ i pavarur i cili merret me trashëgiminë kulturore.

Është problematike në Kosovë sepse krejt ajo që në Kosovë thuhet trashëgimi kulturore, nënkupton kulturën dhe trashëgiminë ortodokse. Si pasojë e zhvillimeve dhe e dëmtimit të një numrit të madh të kishave në vitin 2004, investimet që Qeveria e Kosovës i ka bërë në riparime, restaurime dhe rihvillime në kulturën dhe Kishën ortodokse serbe në Kosovë, perceptimi i publikut është që gjithçka që është trashëgimi kulturore lidhet me kishat dhe me kulturën ortodokse serbe në Kosovë, që nuk është e vërtetë. E vërteta qëndron në atë se nuk ka as balancim të investimeve, as trajtim të çështjes, as të ruajtjes, as të zhvillimit dhe në fund edhe të investimeve që Qeveria duhet të japë në këtë sektor jashtëzakonisht të ndjeshëm. Deputetja nga Grupi i Aleancës e përmendi se sa është shuma e mjeteve që trashëgimia kulturore në Kosovë merr, por një numër i madh i mjeteve vijnë edhe nga donatorët, edhe nga shtetet donatore, edhe nga UNESCO, në forma të ndryshme, jo drejtpërdrejt, për shkak të statusit neutral që e ka në raport me Kosovën, por problemi si i tillë mbetet.

Është shqetësues po ashtu edhe dëmtimi i trashëgimisë kulturore nga ana e shumicës që ka të bëjë, apo motivet që kanë të bëjnë me zhvillim, ku në emër të zhvillimit dhe të ndërtimit dhe të zhvillimit të biznesit të vogël apo të madh, kultura dhe objektet e trashëgimisë nëpër qendrat urbane janë jashtëzakonisht të rrezikuara.

Këshilli i Trashëgimisë është jofunksional, ka munguar vendimmarrja sepse organi, si i tillë, ka pasur mungesë në numrin më të madh të anëtarëve dhe ka qenë një relacion i çuditshëm me Ministrinë e Kulturës, i cili është munduar të rregullohet vitin e kaluar, por nuk ka arritur. Është urgjente që përfundojmë me këtë raport, që këshilli të kompletohet. Qeveria e ka obligim t'i përcjellë në mënyrë urgjente kandidaturat eventuale për këshill, në mënyrë që ky Kuvend t'i emërojë më shpejt dhe ta përballojë këtë situatë.

Dhe, e dyta, është që kultura e shumicës, qoftë ajo e periudhës Ilirio-Dardane, qoftë ajo e periudhës më të vonshme apo të hershme, duhet të trajtohet dhe duhet të mbështetet edhe në kuptimin buxhetor, meqë ministri është këtu, duhet të trajtohet krejt ndryshe, sepse nëse vazhdojmë kështu, është jashtëzakonisht shumë e rrezikuar, ka improvizime, për shembull, në pjesën e Ulpianës, çdo vit e njëjta parcelë hapet, në të njëjtën parcelë bëhen gjurmime dhe e njëjta parcelë mbyllet, mbulohet me dhe dhe konstatohet që ka pasur hulumtime në Ulpianën e Vjetër në Prishtinë, që praktikisht është improvizim, kurrë nuk ka aty, se për 10 vjet e njëjta parcelë hulumtohet, e njëjta parcelë vetëm i harxhon mjetet buxhetore që janë paraparë, ndërsa nuk zhvillohet, sepse problem është prona. Duhet veprim konkret që të zgjidhet problemi pronësor, të blihet ajo tokë e Ulpianës, pronarët janë privatë të tokave, të kompensohen apo të gjendet një mënyrë, Qeveria e ka dosjen. Ministri duhet ta procedojë këtë në mënyrë urgjente, në mënyrë që të zgjidhet problemi i Ulpianës dhe të fillojë të zhvillohet Ulpiana. Si shembull më tipik deri tek ato që duhet të ndërmerren në kuptimin buxhetor jashtëzakonisht shumë janë të rëndësishme për ne dhe për Kosovën nesër. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur. 61 deputetë janë të pranishëm.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e Raportit të Punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për periudhën mars 2009 – 2010, me rekomandimet e Komisionit funksional.

Në mbledhje janë prezentë 61 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani: Faleminderit!

Konstatoj se Kuvendi miratoi Raportin e punës të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore për vitin 2009 – 2010, me rekomandimet e Komisionit funksional me 42 vota “për”, 14 “kundër” dhe 4 abstenime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

#### **10. Shqyrtimi i propozimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese**

Propozimin e Trustit të Kursimit Pensional të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0, 80 në 0.65% e ka shqyrtuar Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Sqarimet e mëtutjeshme do të na jap kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadergjonaj për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të nenit 18 të Ligjit numër 03L/084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, aktivitetet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës financohen përmes pagesave të arsyeshme, duke u bazuar në shpenzimet e llogarive individuale të kontribuuesve në skemën e kursimeve pensionale.

Ndërkaq, në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03L/084 për ndryshimin e rregulloreve që i ceka më parë caktimi i tarifave të arsyeshme të bazuara në shpenzime të çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale në këtë rast për shpenzimet operationale dhe menaxhuese të Trustit të Kursimeve Pensionale dhe ndalimi i shumave të tilla nga kontributet e marra, bëhet para derdhjes së mjeteve në llogaritë individuale në pajtim me orarin të cilin e përcakton Kuvendi, kurse Bordi i Trustit të Kursimeve Pensionale e miraton buxhetin e Trustit.

Bordi udhëheqës i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pajtim me dispozitat e lartpërmendura në nenin 18 dhe 19, i ka propozuar Kuvendit miratimin e uljes së taksës menaxhuese vjetore nga 0,80 në 0,65 mbi Fondin Pensional.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2011, e ka shqyrtuar propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese dhe unanimisht e ka përkrahur këtë propozim.

Me qenë se aktivitetet operacionale dhe menaxhuese të Trustit mbulohen nga mjetet që inkasohen si rezultat i caktimit të tarifës në llogaritë individuale të kontribuuesve, Komisioni i sugjeroj bordit udhëheqës të Trustit që me qëllim të menaxhimit më të mirë të mjeteve pensionale, investimi i këtyre mjeteve në kompanitë investive të bëhet në bazë të performancës së tyre.

Njëkohësisht për qëllim të transparencës dhe arsyeshmërisë së planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve të Trustit nga taksa menaxhuese, Komisioni kërkoi nga bordi udhëheqës i Trustit të Kursimeve Pensionale të dorëzojë një plan të detajizuar të shpenzimeve të Trustit të planifikuar për vitin 2011 i cili plan i është bashkangjitur këtij rekomandimi.

Trusti i Kursimeve Pensionale ka paraparë që gjatë vitit 2011, mesatarisht do t'i ketë në menaxhim 526 milionë euro. Trusti ka planifikuar t'i shpenzojë 3.88 milionë euro, ku nga këto mjete ka paraparë 2 milionë e 600 mijë euro për shpenzime investive, kurse për shpenzime operacionale 1 milion e 279 mijë euro. Ka planifikuar të investojë më shumë në instrumente aktive financiare nga të cilat pritet që edhe kthimi në investim të jetë më i madh se sa kthimet në instrumentet tradicionale më pak aktive.

Po ashtu Trusti ka paraparë një rritje edhe për shpenzimet operacionale për 93 mijë e 560 euro më shumë se në vitin e kaluar, me arsyetimin për përmirësimin e mekanizmit të kontrollit të brendshëm dhe procesimit të dhënave.

Si përfundim Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit që të miratojë propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0,80% në 0,65% dhe e njëjta të jetë e zbatuar nga 1 janari, si dhe rekomandon që sa më shpejtë që të jetë e mundur të fillohet nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin pensional të Republikës së Kosovës, ndryshim i cili është kërkuar edhe në mandatin e kaluar. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Në emër të Partisë Demokratike, besoj e kreve edhe në emër të Partisë, Safete.

Për fjalë është paraqitur Valbona Dibra, në emër të Partisë Demokratike.

**VALBONA DIBRA: Faleminderit!**

I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar zoti ministër Hamza,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar kërkesën e Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për uljen e taksës menaxhuese dhe në bazë të këtij shqyrtimi, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përkrah kërkesën për uljen e taksës menaxhuese nga 0.80% në 0.65% dhe e njëjta të jetë e zbatuar nga 1 janari 2011. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Me qenë se patëm një zbërthim të rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa nga kryetarja Hadergjonaj, mbetet të thuhet që Grupi Parlamentar i LDK-së do ta mbështetë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, me qenë se kemi të bëjmë me një koeficient apo me një taksë menaxhuese që i ndahet Trustit Pensional për menaxhimin e veprimtarisë së vet për çdo vit fiskal. Ata që nuk janë ekonomistë dhe që nuk i shqyrtojnë shumë numrat shtrojnë pyetjen pse ka ulje? Ulja është për arsye se ka rritje të masës së parasë dhe kjo domethënë që në vitin e kaluar ka pasur koeficientin 0.8 nga masa e përgjithshme e parasë ose në mjete monetare absolute ka pasur 3 milionë e 910 mijë e 666 euro, ndërsa për vitin 2011 ky koeficient ulet në 0.65 dhe sasia e parasë llogaritet të jetë për arsye se nuk dihet saktë sa do të ketë mjete në fund të vitit, 3 milionë e 419 mijë euro. Kemi domethënë një deficit prej 491 mijë e 666 euro që mendohet të mbulohet nga suficiti i viteve të kaluara në kuptimin e asaj që të jetë sasia e parave në nivelin e vitit 2010 dhe unë në emër të Grupit iu bëj thirrje deputetëve që për shkak të punës specifike dhe vazhdimësisë së punës së Trustit Pensional të votohet ky koeficient. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” pas shqyrtimit që i ka bërë kërkesës së Trustit të Kursimeve Pensionale për uljen e taksës menaxhuese e përkrah këtë ulje, e përkrah uljen e përqindjes së taksës menaxhuese. Konsiderojmë që kjo në ulje ia lehtëson për një masë të vogël kontribuuesit në Trust barrën që ai paguan për menaxhimin e kursimeve të tij të obligueshme pensionale dhe natyrisht kjo pak ja përmirëson atij pozitën. Kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi shumë vërejtje për sa i përket mënyrës se si funksion tërë sistemi pensional, por edhe shtylla e dytë e pensionit në Kosovës, mirëpo jemi të vetëdijshëm që kjo është një çështje e cila duhet të rregullohet me ligj dhe po ashtu e përkrahim edhe këtë ftesën apo iniciativën që e ka marrë Komisioni për Buxhet dhe Financa, që të diskutohet Ligji për Fondin pensional, por edhe Ligji për sistemin pensional në përgjithësi këtu në Kuvend dhe t’i bëjmë disa ndryshime thelbësore dhe rrënjësore të këtij ligji në mënyrë që ky të jetë në përputhje të plotë me interesat e qytetarëve të Kosovës.

Këtu na është kërkuar që ta votojmë vetëm uljen e taksës menaxhuese të Trustit, jo edhe buxhetin e Trustit të Kursimeve Pensionale, prandaj edhe pse aty shihet që ka disa rritje të disa zërave buxhetor të cilët arsyetohen një farë mënyre me këtë shkresë dërguar nga Trusti i Kursimeve Pensionale, po me qenë se nuk mund të votojmë në këto rritje, atëherë nuk ja vlen edhe të diskutojmë për të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Tash po bindem që jo rastësisht ia kanë lënë emrin Trust dhe është për ta përgëzuar atë që e ka lënë këtë emër se sinqerisht po na qon në atë drejtim.

Unë në emër të Grupit parlamentar të cilit i takoj nuk do ta mbështesim këtë pranim edhe nga ana e Komisionit, sepse konsiderojmë se ulja e taksës. Mendojmë që 0.4 ose 0,45 do të ishte ndoshta e mjaftueshme, po që se i shikoni këtu unë besoj që pas do ditëve do ta kem edhe raportin e Trustit Pensional, këtu i keni që shpenzime për zyra dhe operacione për qira, pasqyra individuale, auditimet e të tjera ka më tepër se sa në ministri, thanë më shumë se sa në një ministri që ka për investime kapitale, kanë ose për kompensime, sigurime, ..... mbledhje të bordit, 227 mijë euro që janë gjithsej 10 ose 15 njerëz. Megjithatë kjo mendoj që është një keqpërdorim i parasë së paguesve të këtij Trusti Pensional ose për këtë Trust Pensional dhe gjithsesi Kuvendi i Kosovës do të duhej të shikojë edhe mundësinë e liberalizimit të mjeteve pensionale, që të mos kemi vetëm një autoritet ku pastaj do të menaxhojë se si ai e sheh më të arsyeshme për vete që të menaxhojë më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputet Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Sa i përket uljes së taksës menaxhuese, sigurisht që pajtohemi të gjithë, por po ta prekim në thelb problemin i cili ka qenë vazhdimisht ka qenë i njohur për qytetarët e Republikës së Kosovës, është vetë mos transparenca e shpenzimeve të cilat bëhen në atë kategorinë që quhet paga e mëditje të Trustit Pensional të Kosovës dhe kjo ulje e taksës nuk do të thotë që Komisioni për Buxhet dhe Financa, po konkretisht Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Banka Qendrore, akoma nuk e kanë sjell para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës se sa janë pagat e njerëzve apo zyrtarëve që punojnë në Trustin Pensional të Kosovës. Sa janë pagat të cilat direkt paguhen nga taksat pensionale dhe kontributet e qytetarëve të Republikës së Kosovës? Po të shikohet në mënyrë detale këtu thotë që ka rritje të numrit të cilët janë kontributdhënës dhe anën tjetër arsyetohet kjo ulje e taksës menaxhuese, por cila është paga mesatare në Trustin Pensional të Kosovës? Për 24 apo 25 punëtorë, përafërsisht paga mesatare është 2000 euro dhe kjo nuk donë kalkulim më të thjeshtë. Edhe në të kaluarën edhe tash, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kërkuar që konkretisht të njihen me pagat dhe statusin e këtyre punëtorëve dhe sot e kësaj dite akoma nuk tregohet kjo dhe nuk bëhet e qartë, arsyet pse është dashur ... edhe Bordi i cili është aty, por edhe Komisioni për Buxhet e Financa, sepse ka qenë një rekomandim nga viti i kaluar që të bëhet transparente paga e zyrtarëve të cilët punojnë në Trustin Pensional të Kosovës dhe kjo vërejtje duhet t'i përcillet edhe Bankës Qendrore edhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka tjerë të paraqitur.

Prezentë janë 61 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet që me 49 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0.80% në 0.65%.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

### **11. Shqyrtimi i Propozim- Programit të punës së Kuvendit, për vitin 2011**

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2011 është hartuar në bazë të Strategjisë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, të planeve të punës së komisioneve parlamentare për vitin 2011 dhe të Planit të veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011.

Programi i punës për vitin 2011 paraqet dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Sipas rregullës, fjalën mund ta marrin kryetarët ose përfaqësuesit e komisioneve parlamentare, nëse e kërkojnë fjalën. Nuk është paraqitur askush. Nga kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare nuk është paraqitur askush, përfaqësuesi i Qeverisë nuk është paraqitur. Deputetët sipas radhës së paraqitur. Është paraqitur deputetja Sala Berisha Shala.

**SALA BERISHA- SHALA:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje të gjithë juve të pranishëm!

Unë shumë shkurt rreth kësaj pike të rendit të ditës. Komisionet parlamentare është dashur ta dorëzojnë planin e tyre të punës, strategjinë legislative në Kryesinë e Kuvendit, por me sa po shoh, nuk është marrë parasysh, nuk e di pse, Plani i punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti Industri. Ndoshta, kjo i është lënë komisionit që të jetë më fleksibil në raport me këtë program dhe në raport me planin e punës që e kemi hartuar ne si Komision dhe shpresoj se do të na jepet mundësi që ta përfillim planin e punës që është miratuar në Komision parlamentar. Për shembull pako e ligjeve që janë paraqitur në këtë draft që e ka sjell Kryesia e Kuvendit këtu siç është Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme janë të parapara të shqyrtohen në maj, ndërsa në pakon e këtyre ligjeve hyn edhe Projektligji për transformimin e pjesshëm të “Trepçës”- ndërmarrjen nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që këto duhet të shkojnë në një pako të veçantë. Kjo është e paraparë në nëntor, kështu që ne si Komision e kemi paraparë që të shkojnë si pako diku të shqyrtohen në maj. Shpresoj që i lejohet komisionit një fleksibilitet i tillë që të harmonizohet me planet që i kanë miratuar në komision. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Zoti Hamiti e ka fjalën.

**SABRI HAMITI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha të them që e kam lexuar këtë program, sepse i bie që është programi themelor i Kuvendit brenda një viti dhe ndoshta deputetët konsiderojnë që këto gjëra i dinë të gjitha dhe i kanë detyrë e s'duhet të flasin për to. Është punë e tyre, po është me rëndësi sot kur të aprovohet ky program të thuhet që është shumë provizor dhe është iluzion që të ndërtohet në formën si është ndërtuar këtu dhe të parashihet i ndarë në muaj, sidomos agjenda legjislative. Njerëzit që e kanë ndërtuar këtë program janë përpjekur ta bëjnë një përpjesëtim të ligjeve nëpër muaj në bazë të asaj që si regjistër ka dhënë Qeveria, po që këta dy muaj të punës së Kuvendit ne na tregojnë që ai ritëm s'ekziston dhe dyshoj që do të përcillet deri në fund të këtij viti. Kjo vlen edhe për programet e komisioneve që i kanë për detyrë si programe funksionale që t'i shqyrtojnë ligjet e veçanta. Kështu që mendoj që evidencat janë dhënë këtu, detyrat që janë dhënë për tri funksionet që i ka Kuvendi edhe punën e përfaqësimit, edhe punën e kontrollit të Qeverisë dhe punën e legjislativit, mirë është që kanë krijuar një rend, po assesi nuk mund të merret si punë e kryer dhe e fiksuar nëpër komisione dhe nëpër muaj, sepse ju do ta shihni vetë posa t'i shihni dy muajt e kaluar, marsin dhe prillin që i keni të evidentuar për ta aprovuar këtë që po e them unë, analizoni marsin dhe prillin dhe do ta shihni çka do të jetë maji dhe qershori. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të paraqitur të tjerë.

Futemi në procesin e votimit. Në sallë janë 66 deputetë prezentë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 56 vota "për", 2 "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011. Uroj që ta realizojmë.

SABRI HAMITI: 170 ligje i ke, shans nuk ka.

KRYESUESI: Atëherë, po vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

## **12. Propozimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore**

Propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore e ka shqyrtuar Komisioni funksional për Legjislacion dhe Kuvendi i ka rekomanduar për miratim.

Sipas radhës kryetari i Komisionit për Legjislacion, më duket nuk është këtu.

Kush e do fjalën në emër të komisionit?

Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e 4 prill 2011 e ka shqyrtuar përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, numër 04P/01K lidhur me propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore dhe vlerëson se propozimi për emërimin e zotit Adem Vokshi, si

anëtar i Komisionit për kërkesa pronësore, është në pajtim me nenin 10 dhe 11 të Ligjit për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale numër 03L/079. Prandaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të propozimit të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe obligimin e Kuvendit për emërimin e anëtarit të Komisionit të theksuar, i rekomandojmë Kuvendit që zoti Adem Vokshi, të emërohet anëtar i Komisionit si kandidat i propozuar. Njëherit japim mbështetjen edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit!**

Në emër të grupeve parlamentare, nuk është paraqitur askush. Nga deputetët nuk është paraqitur askush. Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozimit të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për emërimin e një anëtar i Komisionin për kërkesa pronësore.

Në mbledhje janë prezentë 66 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani. Faleminderit!

Atëherë konstatoj se me 57 vota “për”, 4 abstenime dhe 3 “kundër”, Kuvendi emëroi Adem Vokshin, anëtar të Komisionit për kërkesa pronësore, me mandat njëvjeçar. Faleminderit!

Me kaq konstatoj përfundimin e mbledhjes së sotme. Mirupafshim në mbledhjen e ardhshme!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**